



# PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE DHE VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT

Printuar nga: F&M Reklama  
Tiranë 2018

Ky publikim u mbështet nga projekti “Rritja e kapaciteteve dhe mekanizmave për të identifikuar dhe mbrojtur migrantët e cënueshëm në Ballkanian Perëndimor – FAZA III” financiar nga: U.S. State Department, Bureau of Population, Refugees, and Migration (PRM).

Dokumenti është lëshuar pa redaktim formal nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (ONM).

Shënim:

Pikëpamjet e autorëve të shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e U.S. State Department, Bureau of Population, Refugees, and Migration (PRM) dhe /ose ato të Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (ONM).



International Organization for Migration (IOM)  
The UN Migration Agency

## **Të nderuar miq, kolegë dhe bashkëpunëtorë,**

Dokumenti i Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit (PSV) në Shqipëri është një dokument i rëndësishëm, i cili siguron mbrojtje të gjithanshme, përfshirë identifikimin në kohën dhe mënyrën e duhur të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, të rritur apo të mitur, shqiptarë, të huaj apo persona pa shtetësi, për të gjithë format e shfrytëzimit, të trafikimit të brendshëm apo ndërkombëtar, të lidhur apo jo me krimin e organizuar. Procedurat parashikojnë ndërhyrje të specializuara sektoriale dhe ndërsektoriale/multi-disiplinare, përfshirje më të madhe në identifikimin fillestar dhe të kuptuarit e trafikimit të personave nga institucionet shtetërore dhe jo vetëm dhe, ajo çka është më e rëndësishmja, riintegrimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

Ky dokument vjen pas një pune të gjatë dhe këmbëngulëse në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, dhe një procesi të gjerë konsultimesh, trajnimesh dhe tryezash të rumbullakëta në 12 qarqet e vendit. Në këtë dokument është kontributi, eksperiencia dhe angazhimi i ekspertëve antitrafikim qoftë nga strukturat shtetërore, të cilat kanë detyrim dhe përgjegjësi në këtë fushë, sikurse, strukturat përgjegjëse të: Policisë së Shtetit, Strukturat e Kufirit dhe Migracionit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, anëtarët e Mekanizmit Kombëtar të Referimit, të Autoritetit Përgjegjës, të Komiteteve Rajonale Antitrafikim, ashtu dhe nga qendrat pritëse dhe riintegruese të viktimave të trafikimit në vend, dhe përfaqësues të Prokurorisë, OJF-ve dhe organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare që janë aktivë në fushën e antitrafikimit.

Ai, gjithashtu, është në sintoni dhe harmoni të plotë me standardet më të mira ndërkombëtare që kanë në fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe në sinergji me mekanizmat e tjerë të mbrojtjes ndaj dhunës, apo mbrojtjes së fëmijëve.

Të gjitha strukturat do të kenë në tryezën e tyre këtë manual pune të vlefshëm dhe të qartë për të identifikuar, referuar, asistuar mbrojtur dhe riintegruar viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit.

Unë i falënderoj nga zemra të gjithë aktorët kontribues të hartimit të këtij dokumenti.

### **Rovena Voda**

*Zëvendësministër i Brendshëm*

*Koordinator Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave*

Nr. 499, datë 29.8.2018

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE DHE VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8920, datë 11.7.2002, “Për ratifikimin e “Konventës së Kombeve të Ba shkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe dy protokolleve shtesë të saj”, si dhe të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore’”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi nr. 582, datë 27.7.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”, shfuqizohet.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME

# PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE DHE VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT

## PASQYRA E LËNDËS

1. Qëllimi i Procedurave Standarde.....	3
2. Shkurtime.....	4
3. Parimet.....	6
4. Përkufizimet.....	7
5. Kuadri ligjor.....	14
6. Shpjegime të përgjithshme mbi procedurat dhe organizimin e mëtejshëm të dokumentit.....	17
7. Identifikimi dhe reagimi fill estar.....	18
8. Identifikimi formal.....	60
9. Planifikim dhe Mbështetje për Riintegrim.....	69
10. Planifikim dhe Mbështetje për kthim vullnetar të asistuar .....	79
11. Mbështetje e hetimit dhe dënimit të trafikantëve .....	84
12. Formatet.....	85

## 1. QËLLIMI I PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT

Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, në vijim Procedurat, hartohen në zbatim të Strategjisë së Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe Planit të saj të Veprimit (miratuar me VKM nr. 814, datë

26.11.2014), si dhe Planit të Veprimit për riintegrimin social-ekonomik për gra dhe vajza viktime të trafikimit (miratuar me VKM, nr. 115, datë 17.02.2016). Ato kanë për qëllim kryesor mbrojtjen, përfshirë identifikimin në kohën dhe mënyrën e duhur të viktimeve/viktimeve të mundshme të trafikimit, të rritur apo fëmijë, shqiptarë, të huaj apo persona pa shtetësi, për të gjithë llojet e shfrytëzimit, të trafikimit të brendshëm apo ndërkombëtar, të lidhur apo jo me krimin e organizuar.

Procedurat parashikojnë situata në të cilat vendi ynë, Shqipëria, apo zona të caktuara të vendit, përdoren, apo mund të përdoren si vend origjine, tranziti dhe destinacioni për lëvizjen dhe shfrytëzimin e viktimeve/viktimeve të mundshme të trafikimit, shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi, si edhe situata në të cilat, viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit me shtetësi shqiptare, apo të hamendësuar shqiptare ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Procedurat parashikojnë ndërhyrje të specializuar sektoriale dhe ndërsektoriale/multidisiplinore. Zbatimi i tyre është detyrim i të gjitha institucioneve shtetërore, në nivel qendror dhe lokal që punojnë në vend apo janë me mision shtetëror jashtë vendit. Veprimi në përputhje me këto procedura është gjithashtu detyrim edhe i gjithë agjencive joshetërore që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në çdo moment në të cilin ato, gjatë veprimtarisë së tyre, bien në kontakt me një person që dyshojnë se mund të jetë trafikuar apo informohet tek ata se është viktimë/viktimë e mundshme trafikimi, duhet të vihen menjëherë në kontakt dhe të konsultohen me Autoritetin Përgjegjës. Ato gjithashtu, nënkuptojnë bashkëpunimin me strukturat analoge në vende të tjera.

Procedurat bazohen në eksperiencën e deritanishme në zbatim të vendimit nr. 582 datë 27.07.2011 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimeve/viktimeve të mundshme të trafikimit”, detyrimeve që rrjedhin nga “Marrëveshja e Bashkëpunimit për Funksonimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Viktimat dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit të Personave” (nënshkruar në vitin 2012), si dhe marrëveshjeve, protokolleve dhe memorandumeve të bashkëpunimit mes institucioneve në vend dhe institucioneve shqiptare me ato të vendeve të ndryshme.

Ato reflektojnë ristrukturimin e Autoritetit Përgjegjës të ngritur me Udhëzimin e përbashkët nr. 3799, datë 8.7.2014<sup>1</sup> “Për Ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për Identifikimin, Referimin, Mbrojtjen dhe Riintegrimin e Viktimeve/ Viktimeve të Mundshme të trafikimit”.

Procedurat janë hartuar në të njëjtën frymë me instrumentet ndërkombëtare që trajtojnë çështjet e parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të personave, si dhe reflektojnë rekomandimet e dhëna për të njëjtën fushë veprimi nga organizma ndërkombëtare, si: OKB, DASH, KiE, IOM, OSBE, UNICEF, ICMPD, UNODC, etj.

## 2. SHKURTIMET

AP                      Autoriteti Përgjegjës

---

<sup>1</sup> Ministrin të Punëve të Brendshme, i Ministrin të Arsimit dhe Sportit, i Ministrin të Punëve të Jashtme, i Ministrin të Shëndetësisë, i Ministrin të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

A/IPIF	Agjencitë/Institucionet Përgjegjëse për Identifikim Fillestar
A/IPM	Agjencitë/ Institucionet Përgjegjëse për Mbrojtjen
APAP	Anëtari Përkatës i Autoritetit Përgjegjës
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
DASH	Departamenti Amerikan i Shtetit
NJAV	Njësia arsimore vendore
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DRKM	Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit
DRSHSSH	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
DRSH	Drejtoria Rajonale Shëndetësore
DSHP	Drejtoria e Shëndetit Publik
D/KAP	Drejtuesi/ Kryetari i Autoritetit Përgjegjës
G/SPIF	Grupi/ Struktura Përgjegjëse për Identifikim Formal
GTN	Grupi Teknik Ndërsektorial
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnim në Hetimet Penale
ICMPD	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimit
KB/UN	Kombet e Bashkuara
KiE	Këshilli i Europës
KK	Koordinatori Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave
KRAT	Komitetet Rajonale Antitrafikim
KSHNJ	Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike
MB	Ministria e Brendshme
MKR	Marrëveshja për Mekanizmin Kombëtar të Referimit
MPEJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MD	Ministria e Drejtësisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
NJVRN	Njësia e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave
UNHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të KB
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PDRSH	Përfaqësitë Diplomatike të Republikës së Shqipërisë
PPDRSH	Punonjësi i Përfaqësisë Diplomatike të Republikës së Shqipërisë
PKK	Pika e Kalimit Kufitar
PMF	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve



PSV	Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit
SLKTP	Spektori i Luftës kundër Trafikeve të Paligjshme
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogat
VT	Viktimë trafikimi
VMT	Viktimë e mundshme trafikimi
ZRSHSSH	Zyra Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror

### 3. PARIMET E PËRGJITHSHME

Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit janë ndërtuar mbi parimet drejtuese të mëposhtme, të cilat përbëjnë kuadrin konceptual për mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.

1. Qasja e Procedurave Standarde të Veprimit është e bazuar në të drejtat e njeriut dhe është një qasje sensitive për mbrojtjen e viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit, duke synuar interesin më të lartë të saj.
2. Mbrojtja e të drejtave të personave të trafikuar do të jetë në qendër të të gjitha përpjekjeve për parandalimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e tyre, pavarësisht dëshirës apo aftësisë së viktimës për të dëshmuar në gjykatë. Ofrimi i mundësisë për t'u rehabilituar, dhënia e mundësisë që të rifillojnë jetën normale, nuk është thjesht një detyrim njerëzor i shtetit, por edhe një masë parandaluese ndaj ritrafikimit.
3. Çdo personi të identifikuar si viktimë apo viktimë e mundshme trafikimi do t'i ofrohet ndihmë dhe mbrojtje falas dhe do t'i garantohet në kohë ndihma dhe mbrojtja e zgjedhur prej tij/saj. Të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me viktimat e trafikimit apo viktimat e mundshme të trafikimit do të kryhen në çdo moment duke marrë masa serioze të ruajtjes së sigurisë.
4. Megjithëse është fryt i përpjekjeve të bashkërenduara të qeverisë, organizatave shërbim ofruese për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë, përgjegjësia për zbatimin e Procedurave Standarde të Veprimit bie mbi institucionet shtetërore. Si rrjedhojë, institucionet shtetërore angazhohen të mobilizojnë burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare për implementim, kryesisht nga burimet e tyre.
5. Asnjë masë kundër trafikimit të personave nuk do të çënojë të drejtat dhe dinjitetin e njeriut, në veçanti të drejtat e personave të trafikuar, të migrantëve, të personave të zhvendosur, pa shtetësi, refugjatëve dhe azil -kërkuesve.

6. Procedurat Standarde të Veprimit marrin në konsideratë në mënyrë specifike detyrimin e posaçëm që ka shteti në lidhje me fëmijët, më konkretisht mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (1989), dhe Ligjit nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” bazuar në interesin më të lartë të saj.
7. Identifikimi dhe referimi për ndihmë i personave të trafikuar bëhet në bashkërendim dhe bashkëpunim të plotë të të gjitha autoriteteve dhe strukturave shtetërore ose joshetërore. Identifikimi i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit do të bëhet jo si qëllim në vetvete, por për t’i ndihmuar dhe mbrojtur ata/ato.
8. Zbatimi i procedurave për identifikim, referim dhe ndihmë për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit do të bëhet pa asnjë lloj diskriminimi mbi seksin racën, ngjyrën, gjuhën, besimin, bindjet politike apo të tjera, origjinën shoqërore apo kombësinë, pronën, lindjen apo çdo lloj statusi tjetër.
9. Kthimi vullnetar i asistuar për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit do të mundësohet dhe garantohet nga vendi i origjinës dhe i destinacionit, duke bërë vlerësimin e situatës së personave në vendin dhe familjen e origjinës para kthimit dhe marrjen e vendimit të kthimit në interesin më të lartë të tyre.
10. Qeveria ushtron kujdesin e duhur në identifikimin, në parandalimin e përfshirjes së zyrtarëve publikë të implikuar në trafikim dhe merr masat për dënimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi.
11. Kurdoherë që është e nevojshme dhe e mundshme, viktimave të trafikimit do t’u ofrohet përfshirja në programin e mbrojtjes së dëshmitarit.
12. Pjesëmarrja e organizatave shërbim ofruese për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit dhe e shoqërisë civile është e domosdoshme për arritjen e synimeve të Procedurave Standarde të Veprimit, d.m.th. mbrojtjen, parandalimin dhe ndihmën ndaj viktimave të këtij krimi. Të gjithë aktorët shtetërorë dhe joshetërorë, përfshirë shoqërinë civile, marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e veprimtarisë antitrafik, në monitorimin e zbatimit të saj dhe në shqyrtimin e rregullt.
13. Organizatat e shoqërisë civile, dhe në veçanti OJF-të, luajnë një rol kyç në luftën kundër trafikimit të personave, dhe si të tilla, mendimet dhe pikëpamjet e tyre janë të pasqyruara mirë në hartimin dhe zbatimin e këtyre Procedurave Standarde të Veprimit.

#### 4. PËRKUFIZIME

**“Viktimë trafikimi” (VT), ka të njëjtin kuptim** sipas gremës “e” të nenit 4, të ligjit nr. 9642 datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”.

**“Viktimë e mundshme trafikimi” (VMT)**, është personi, për të cilin/të cilën, agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikim fillestar, bazuar në treguesit/indikatorët/dritën e rrethanave të veçanta të rasteve, në të cilën, të paktën **tre ose më shumë** elementë përbëjnë dyshimin e arsyeshëm se personi mund të jetë trafikuar.

**“Fëmijë”<sup>2</sup>**, është çdo person nën moshën 18 vjeç.

**“Fëmijë në nevojë për mbrojtje”<sup>3</sup>**, është personi nën moshën 18 vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo ndonjë veprimtarie tjetër kriminale, si edhe individ i nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer një vepër penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin.

**“Interesi më i lartë i fëmijës”**, është një koncept trekuptimsh, një e drejtë themelore, një parim themelor i interpretimit të ligjit, dhe një rregull procedural. Interesi më i lartë i fëmijës është e drejta themelore e fëmijës, që sa here duhet të merret një vendim lidhur me një fëmijë, një grup i identifikuar apo i paidentifikuar fëmijësh ose fëmijët në përgjithësi, të vlerësohet se cilat janë interesat e fëmijës dhe këto interesa të qëndrojnë më lart se interesat e palëve të tjera. Si parim themelor i interpretimit të ligjit ka kuptimin që, nëse një parashikim ligjor është i hapur për më shumë se një interpretim, duhet të zgjidhet interpretimi që i shërben më mirë interesave të fëmijës. Si rregull procedural ka kuptimin që sa herë duhet të ketë një vendim që prek një fëmijë, apo grup fëmijësh, procesi vendimmarrës duhet të përfshijë një vlerësim të të gjitha efekteve (pozitive dhe negative) të vendimit mbi fëmijën dhe/ose grupin e fëmijëve<sup>4</sup>.

**“Mbrojtje e personave të trafikuar”**, përfshin të gjitha veprimet e kryera nga punonjës të institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore, si dhe të institucioneve joshitetërore-anëtare ose jo të Mekanizmit Kombëtar të Referimit për pritjen, identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe ndihmën për rehabilitimin dhe ri-integrimin e sigurt të personave të trafikuar në përputhje me këto procedura. Të gjithë institucionet e ngarkuara në këtë dokument kontribuojnë në mbrojtjen, në të gjitha momentet, që nga identifikimi deri tek ri/integrimi i plotë i personave të trafikuar, por për lehtësi të kuptuarit dhe orientimit në dokument, mbrojtja përfshin:

- Identifikim dhe reagim fillestar
- Identifikim formal
- Planifikim dhe Mbështetje për Riintegrim
- Planifikim dhe Mbështetje për Kthim Vullnetar të Asistuar
- Pritje e personave të trafikuar me shtetësi shqiptare
- Kthim vullnetar i asistuar për shtetasit e huaj
- Mbështetje e hetimit dhe dënimit të trafikantëve

---

<sup>2</sup> Sipas nenit 3 “Përkufizime“ të Ligjit 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

<sup>3</sup> Sipas nenit 3 “Përkufizime“ të Ligjit 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

<sup>4</sup> CRC/C/GC/14, [http://ëëë2.ohchr.org/English/bodies/crc/docs/GC/CRC\\_C\\_GC\\_14\\_ENG.pdf](http://ëëë2.ohchr.org/English/bodies/crc/docs/GC/CRC_C_GC_14_ENG.pdf),

**“Agjencitë/ Institucionet Përgjegjëse për Mbrojtjen (A/IPM)”**, janë të gjitha institucionet e përmendura në këtë dokument, si përgjegjëse kryesore lidhur me veprimet për mbrojtjen e personave të trafikuar.

**“Identifikim dhe reagim fillestar”**, është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e personave të trafikuar në kufijtë dhe brenda territorit të RSH-së, si të institucioneve vendore, ashtu edhe qendrore që bën të mundur përcaktimin se një person i/e mitur apo i/e rritur është viktimë e mundshme e trafikimit të personave. Mjetet e identifikimit fillestar janë **treguesit dhe intervista**: në rast se në sjelljen dhe paraqitjen e personit ka elementë që janë të përfshirë në listën e treguesve, atëherë personi kalohet në intervistë fillestare.

**“Identifikimi Formal”**, është identifikimi i një personi si viktimë trafikimi, i kryer vetëm nga Grupi/Struktura Përgjegjëse për Identifikim Formal (G/SPIF) në bazë të formatit të intervistës formale të përfshirë në këtë dokument. Mjeti i vetëm i identifikimit formal është intervista formale/zyrtare.

**“Planifikim dhe Mbështetje për Rehabilitim dhe Ri/integrim”**, është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e personave të trafikuar në kufijtë dhe brenda territorit të RSH-së, si ata të institucioneve vendore, ashtu edhe ata qendrore (në veçanti anëtarët e AP-së). Këto veprime duhet të përfshijnë minimalisht: 1. vlerësimin e thelluar të nevojave të personave të trafikuar; 2. hartimin e planeve të mbështetjes; 3. ndihmën direkte për rehabilitimin dhe ri/integrimin/fuqizimin e personit të trafikuar; 4. informimin e AP-së për ecurinë e mbështetjes.

**“Pritje e personave të trafikuar me shtetësi shqiptare”**, janë veprimet e institucioneve/agjencive të ngarkuara me mbrojtjen e personave të trafikuar që sigurojnë pritjen e personave të trafikuar/të dyshuar të trafikuar me shtetësi shqiptare dhe vijimësinë e mbrojtjes.

**“Planifikim dhe Mbështetje për Kthim Vullnetar të Asistuar”**, është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e personave të trafikuar në kufijtë, brenda dhe jashtë territorit të RSH-së, si ata të institucioneve vendore, ashtu edhe ata qendrore (sidomos anëtarët e AP-së) që bën të mundur kthimin e sigurt, vullnetar dhe të asistuar të një personi të trafikuar me shtetësi të huaj në vendin e origjinës. Këto veprime duhet të përfshijnë minimalisht: 1. vlerësimin e situatës së personave në vendin dhe familjen e origjinës para kthimit; 2. informimin e personit dhe kujdestarit të tij/saj për vlerësimin; 3. marrjen e vendimit të kthimit në interesin më të lartë të fëmijës/personit të trafikuar; 4. marrjen e masave që kthimi të jetë i asistuar/ i sigurt; 5. sigurimin që personat e trafikuar nuk do të ndiqen penalisht në vendin e tyre të kthimit; 6. sigurimin e vazhdimësisë së trajtimit të personit të trafikuar në përputhje me nevojat e tij/saj; 7. parandalimin e riviktimizimit/rënies pre e trafikimit; 8. sigurimin e ndjekjes penale të trafikantëve dhe kompensimit të personave të trafikuar.

**“Mbështetje e hetimit dhe dënimit të trafikantëve dhe shfrytëzuesve”**, është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e personave të trafikuar në kufijtë, brenda dhe jashtë territorit të RSH-së, si ata të institucioneve vendore, ashtu edhe ata qendrore (sidomos anëtarët e AP-së) që bën të mundur grumbullimin e informacionit për hetimin dhe ndjekjen e trafikantëve. Këto veprime duhet të përfshijnë minimalisht: 1. informimin e personit dhe

kujdestarit të tij/saj për nevojën e ndarjes së informacionit mbi trafikantët; 2. shoqërimin e personave të trafikuar në identifikim formal; 3. informimin e AP-së për modus operandi të trafikantëve.

**“Autoriteti Përgjegjës” (AP)**, është strukturë e ngritur me Udhëzimin e Përbashkët Nr. 3799, datë 8.7.2014<sup>5</sup> “Për Ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për Identifikimin, Referimin, Mbrojtjen dhe Riintegrimin e Viktimave/viktimave të Mundshme të trafikimit”, Autoriteti Përgjegjës përbëhet nga përfaqësues të ministrive nënshkruese të udhëzimit për ngritjen e tij, si dhe një përfaqësues i Koalicionit Kombëtar të Strehëve Antitrafik.

**“Anëtari Përkates i Autoritetit Përgjegjës (APAP)”**, është anëtari i Autoritetit Përgjegjës tek i cili/e cila drejtohet çdo profesionist apo staf i institucionit dhe strukturave të varësisë së institucionit që ai/ajo përfaqëson në lidhje me viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit. APAP e bën të njohur pozicionin e tij/saj tek strukturat bazë të institucionit që përfaqëson, shërben si marrës dhe përcjellës i informacionit të institucionit dhe strukturave në varësi tek Autoriteti Përgjegjës, komunikon me Drejtuesin/Kryesuesin e AP-së, Sekretariatit Teknik të AP-së dhe anëtarët e tjerë lidhur me nevojat e rasteve, udhëzon dhe monitoron veprimet e strukturave për mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.

**“Drejtues/Kryesues i Autoritetit Përgjegjës (D/KAP)”**, është Drejtori i Drejtorisë së Antitrafikut dhe Migracionit në Ministrinë e Brendshme.

**“Tregues të trafikimit”**, janë elementë përshkrues të procesit të trafikimit që reflektojnë paraqitjen e efekteve/pasojave të trafikimit tek personat me shtetësi shqiptare ose të huaj deri në hartimin e këtij dokumenti. Në këtë dokument treguesit janë të ndarë në dy kategori: për fëmijë dhe për të rritur.

**“Rishikimi dhe formalizimi i treguesve të trafikimit”**, është proces i ndërmarrë nga Institucionet dhe Agjencitë Përgjegjëse, kryesisht nga Koordinatori Kombëtar ose Autoriteti Përgjegjës për të rishikuar treguesit e përdorur për identifikimin fillestar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit mbi bazën e eksperiencave dhe komunikimit me strukturat në bazë/strukturat e varësisë. Rishikimi kryhet një herë në dy vjet dhe miratohet me “Udhëzim” të ministrive përkatëse.

**“Nevojat/të drejtat bazë gjatë identifikimit dhe reagimit fillestar dhe plotësimi i tyre”**, përfshijnë minimalisht nevojat/të drejtat bazë për ushqim, për fjetje, strehim, asistencë mjekësore, psiko-sociale, komunikim në një gjuhë të kuptueshme, kontakt me familjen, etj.

**“Nevojat/ të drejtat bazë të mbrojtjes së personave të trafikuar”**, përfshijnë minimalisht ofrimin falas të një pakete shërbimesh, si: strehim të përshtatshëm dhe të sigurt, ndihmë psikologjike dhe materiale, trajtim mjekësor të menjëhershëm dhe ruajtje të shëndetit në vazhdim, përkthim kur është e nevojshme, këshillim dhe informacion, sidomos për të drejtat ligjore, ndihmë për paraqitje dhe marrje në konsideratë gjatë procedimit të trafikantëve, qasje në shkollim, trajnim profesional dhe punësim.

---

5 I Ministrisë së Punëve të Brendshme, i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, i Ministrisë së Punëve të Jashtme, i Ministrisë së Shëndetësisë, i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

**“Masa emergjente e mbrojtjes”**<sup>6</sup>, është një masë e përkohshme mbrojtjeje e marrë nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, për largimin e fëmijës dhe vendosjen në përkujdesje alternative kur vlerësohet të jetë në situatë rreziku të lartë dhe të menjëhershëm për shkak të abuzimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo çdo formë dhune dhe për të cilin punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe strukturat e policisë së shtetit apo prokurorisë kanë dyshime ose fakte se familja apo mjedisi ku i mituri qëndron nuk është e sigurt për fëmijën.

**“Menaxheri i rastit”**, sipas këtij dokumenti është një punonjës social, psikolog ose staf i trajnuar i caktuar me qëllim dhënien e ndihmës dhe ndërmjetësimin për ndihmë për personat e trafikuar. Menaxheri i rastit vepron brenda një grupi këshillimor me profesionistë të tjerë, kur duhet të merren vendime mbi planin e përkujdesjes për secilin person. Menaxheri i rastit, në rastin e një të mituri të dyshuar si i trafikuar ose të identifikuar si i/e trafikuar nga G/SPIF është punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve në njësinë vendore ku asistohet rasti, ose punonjësi social i qendrës pritëse apo rehabilituese për viktimat e trafikimit.

**“Ri/integrim i personave të trafikuar”**, është procesi i rikuperimit dhe përfshirjes sociale dhe ekonomike pas një përvoje trafikimi. Përfshin vendosjen në një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm, akses në standard jetese të arsyeshëm, mirëqenie fizike dhe mendore dhe mundësi për zhvillim personal, social, ekonomik dhe akses në mbështetje sociale dhe emocionale. Një aspekt qendror i ri/integrimit të suksesshëm është ai i fuqizimit, mbështetjes së viktimave për të zhvilluar aftësitë drejt pavarësisë dhe vetë-mjaftueshmërisë dhe për t'u përfshirë në mënyrë aktive në rikuperimin dhe ri/integrimin e tyre.

**“Komunikim i sigurt etik me personat e trafikuar”**, quhen komunikimet në ambiente të sigurta, që ruajnë parimet e: mosdëmtimit, sigurisë fizike, konfidencialitetit, mosdiskriminimit, komunikim të qartë dhe të kuptueshëm, tolerancës etj.

**“Informacioni për mbështetjen e hetimit”**, është informacioni që jep viktimat/viktima e mundshme e trafikimit gjatë intervistimit nga G/SPIF ose gjatë procesit të riintegrit, i cili i kalohet Autoritetit Përgjegjës për ndjekje të mëtejshme nga struktura përgjegjëse për hetimin.

**“Vendim i informuar”**, është vendimi i marrë nga një person për përfshirjen ose jo të tij/saj në një procedurë të vlerësimit të nevojave të tij/saj, marrjen ose jo të një shërbimi që plotëson nevojat e tij/saj, vetëm pasi personi është informuar në mënyrë të plotë për procedurën, shërbimin, dhe alternativat e tjera për vlerësimin dhe plotësimin e nevojave të tij /saj.

**“Trafikim i personave”**, ka të njëjtin kuptim sipas nenit 110/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

**“Trafikimi i të miturve”**, ka të njëjtin kuptim sipas nenit 128/b të Kodi Penal të Republikës së Shqipërisë.

**“I/e mitur”**, është personi nën moshën 18 vjeç, në përputhje me legjislacionin penal dhe civil në fuqi.

---

<sup>6</sup> Sipas nenit 55 dhe 56 të “Ligjit 18/2017 “Për Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

**“Dëshmitar i drejtësisë”**, është personi i cili, në cilësinë e dëshmitarit apo personit të dëmtuar bën deklarime a dëshmon për fakte e rrethana, që përbëjnë objekt prove në një procedim penal dhe që për shkak të këtyre deklarimeve e dëshmime, ndodhet në një gjendje rreziku<sup>7</sup>.

**“Trafikant i qenieve njerëzore”**, është çdo person i dënuar me vendim Gjykate të formës së prerë për veprat penale të trafikimit të personave.

**“Prind”**, është personi që e ka lindur ose e ka birësuar fëmijën, çift ose i vetëm, i martuar ose jo apo që ka njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese.<sup>8</sup>

**“Përfaqësues procedural”**, është personi i caktuar nga autoriteti procedues nga lista e dërguar nga njësia për mbrojtjen e fëmijës, që do të kryejë përfaqësimin procedural të fëmijës në mungesë të përfaqësuesit të tij ligjor ose, në rast konflikti interesi mes tij dhe fëmijës dhe ka të drejta përfaqësuese në emër të fëmijës në konflikt me ligjin, ose fëmijës dëshmitar/viktimë, me qëllim për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës<sup>9</sup>.

**“Ndhim për kalim të paligjshëm të kufijve”**, ka të njëjtin kuptim sipas nenit 298 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

**“I/e mitur i/e pashoqëruar”**, është i mituri i huaj, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë, i pashoqëruar nga një person madhor përgjegjës, sipas ligjit dhe për sa kohë që nuk merret efektivisht në përkujdesje prej tij, ose i mituri që lihet i pashoqëruar, pas hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë<sup>10</sup>.

**“Fëmijë i pashoqëruar”**, është i mituri që është ndarë nga të dy prindërit ose të afërmit e tjerë të familjes dhe për të cilin nuk kujdeset ndonjë person madhor, sipas këtij ligji<sup>11</sup>.

**“Azilkërkues”**, është çdo i huaj apo person pa shtetësi, që shpreh në çfarëdolloj mënyre se nuk dëshiron të kthehet në vendin e tij, si dhe çdo i huaj apo person pa shtetësi që ka paraqitur një aplikim për azil në Republikën e Shqipërisë, për të cilin nuk është marrë ende një vendim përfundimtar.<sup>12</sup>

**“Certifikatë regjistrimi”**, është dokumenti i lëshuar nga autoriteti shtetëror përgjegjës, për të huajin e punësuar në Republikën e Shqipërisë që përjashtohet nga detyrimi për t’u pajisur me leje pune.<sup>13</sup>

---

<sup>7</sup> Neni 3 i Ligjit nr. 10173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”

<sup>8</sup> Sipas nenit 3 “Përkufizime“ të ligjit Nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

<sup>9</sup> Sipas nenit 3 “Përkufizime“ të ligjit Nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

<sup>10</sup> Sipas pikës 31 të nenit 3 të ligjit Nr.108/2013 “Për të huajt”

<sup>11</sup> Sipas nenit 3 “Përkufizime“ të ligjit Nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

<sup>12</sup> Sipas pikës ç, të nenit 3 të ligjit nr 121/2014 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”

<sup>13</sup> Sipas pikës 16 të nenit 3 të ligjit Nr. 108/2013 “Për të huajt”

**“Leje qëndrimi”**, është dokumenti i lëshuar nga autoritetet kompetente, sipas ligjit “Për të huajt”, i cili autorizon dhe lejon të huajin të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë më shumë se 90 ditë brenda 180 ditëve. Kjo leje qëndrimi i jepet viktimës ose viktimës së mundshme të trafikimit me qëllim që të rimarrë veten, si dhe të trajtohet sipas gjendjes fizike dhe mendore për marrjen e një vendimi të mirinformuar për të bashkëpunuar ose jo me organet e drejtësisë.<sup>14</sup>

**“Leje pune”**, është autorizimi i lëshuar, në përputhje me nenin 101 të ligjit “Për të huajt”, nga autoriteti shtetëror përgjegjës një të huaji, për qëllime biznesi, për t’u punësuar, vetëpunësuar ose për formim profesional.<sup>15</sup>

**“Shërbime të kujdesit shoqëror”**, është një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.<sup>16</sup>

**“Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH)”**, është institucion në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale. Monitoron zbatimin e legjislacionit të shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin, nëpërmjet strukturave të njësisë qendrore dhe drejtorive rajonale.<sup>17</sup>

**“Ndhimë ekonomike”**, është mbështetja, në para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar. Viktimat e trafikimit përfshihen në përfituesit e ndihmës ekonomike, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimit të tyre<sup>18</sup>.

**“Strehëzat/qendrat për viktimat e trafikimit”**, kanë të njëjtin kuptim sipas ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

**“Baza e të dhënave për viktimat e trafikimit SIVET”**, është një bazë të dhënash e integruar në sistemin TIMS, i cili është i vetmi burim zyrtar për statistikat në lidhje me viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit.

**“Kallëzimi”**, është referimi i fakteve që lidhen me veprën penale. Kallëzimi i viktimës së trafikimit të mitur e të rritur si persona të dëmtuar nga vepra penale, është vullnetar, dhe bëhet sipas përcaktimeve specifike të Kodit të Procedurës Penale.

**“Refugjat”**, është i huaji apo personi pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij ose vendit të zakonshëm të banimit dhe nuk ka mundësi ose dëshirë për të kërkuar mbrojtjen e atij vendi apo kthimin në atë vend, si pasojë e këtyre rrethanave, në përputhje me kriteret e nenit 1(A) të Konventës së Gjenevës.<sup>19</sup>

<sup>14</sup> Sipas pikës 23 të nenit 3 të ligjit Nr 108/2013 “Për të huajt”

<sup>15</sup> Sipas pikës 22 të nenit 3 të ligjit 108/2013 “Për të huajt”

<sup>16</sup> Sipas pikës 1 nenit 3 të ligjit nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

<sup>17</sup> Neni 32 i ligjit nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

<sup>18</sup> Sipas nenit 5 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar

<sup>19</sup> Sipas germës d, të nenit 3 të ligjit nr 121/2014 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”



## 5. KUADRI LIGJOR

### Legjislacioni ndërkombëtar

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
- Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve për sa i përket Përpunimit Automatik të të Dhënave Personale
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës
- Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut<sup>20</sup>
- Protokolli shtesë i Konventës për të Drejtat e Fëmijës për Shitjen e Fëmijës, Prostitucionin e Fëmijës dhe Pornografinë e Fëmijës<sup>21</sup>
- Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional/“Protokolli Shtesë mbi “Parandalimin, shtypjen, dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, në mënyrë të veçantë të grave dhe fëmijëve”<sup>22</sup>
- Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional/ “Protokolli kundër Kontrabandimit të Emigrantëve në Rrugë Tokësore, Ajrore dhe Detare”<sup>23</sup>
- Konventa e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave CEDAË<sup>24</sup>
- Konventa e Këshillit të Europës “Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”<sup>25</sup>
- Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijës “Mbi shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve”
- Konventa e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore, datë 24.04.1963
- Konventa e Konferencës së Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”<sup>26</sup>
- Konventa e Konferencës së Hagës “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”<sup>27</sup>
- Konventa e Konferencës së Hagës “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”<sup>28</sup>
- Konventa e Konferencës së Hagës “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore”<sup>29</sup>

<sup>20</sup> Ratifikuar me Ligjin Nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për Ratifikimin e Konventës Europiane Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, Fletorja Zyrtare Nr 20, viti i botimit 1996.

<sup>21</sup> Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin Nr. 9834, datë 22.11.2007 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Fëmijëve”, Për Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin dhe Pornografinë me Fëmijë” Fletorja Zyrtare Nr. 165, Viti i botimit 2007.

<sup>22</sup> Ligji nr. 8920, datë 11.07.2002, Fletore Zyrtare nr. 41, korrik 2002.

<sup>23</sup> [ee.uncij.org/documents/conventions](http://ee.uncij.org/documents/conventions)

<sup>24</sup> Ratifikuar me Ligjin nr. 1769, datë 11.05.1994

<sup>25</sup> Ratifikuar nga kuvendi i shqipërisë me ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006 “për ratifikimin e konventës së këshillit të europës “për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore””, fletorja zyrtare nr. 132, viti i botimit 2006

<sup>26</sup> Aderuar me ligjin nr. 8624, datë 24.06.2000

<sup>27</sup> Aderuar me ligjin nr. 9443/2005

<sup>28</sup> Aderuar me ligjin nr. 9446/2005

- Konventa e Konferencës së Hagës “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore”<sup>30</sup>
- Konventa e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit dhe abuzimeve seksuale”<sup>31</sup>
- Konventa e Këshillit të Europës “Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës”<sup>32</sup>
- Konventa e Këshillit të Europës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”<sup>33</sup>
- Konventa e Konferencës së Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes” (miratuar në parim, nga Këshilli i Ministrave, në mbledhjen e datës 26.05.2011).
- Konventa e Këshillit të Evropës “Kundër Trafikimit të Organeve Njerëzore”<sup>34</sup>

## Legjislacioni vendas

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale
- Kodi Civil dhe Kodi i Procedurës Civile
- Kodi i Familjes
- Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur
- Ligji nr. 9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar, i cili parashikon rregulla për realizimin me sukses të procedurave të birësimit të fëmijëve, duke ndikuar kështu edhe në shmangien e rasteve të trafikimit të fëmijëve
- Ligji nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, në të cilin parashikohen rregullat mbi forcimin e bashkëpunimit gjyqësor për çështjet penale, përfshirë edhe ato të trafikimit
- Ligji nr. 8677, datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar me ligjin nr. 10 301, datë 15.07.2010, *i cili synon të forcojë marrëdhënien polici gjyqësore – prokurori me qëllim rritjen e efikasitetit të luftës kundër krimit të organizuar përfshirë edhe trafikimin*
- Ligji nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, të ndryshuar, *në të cilin parashikohet se gjykata ose organi përkatës shtetëror, brenda kompetencave të parashikuara në ligj, detyrimisht ftojnë palët për zgjidhjen me ndërmjetësim, veçanërisht për mosmarrëveshjet në çështjet civile dhe familjare, kur ndërthuren interesat e të miturve.*

Më specifikuat në legjislacionin vendas është marrë në konsideratë:

- Kodi Penal, Neni 110/a “Trafikimi i të rriturve” dhe neni 128/b “Trafikimi i të miturve”
- Kodi Penal, Neni 298 “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”

<sup>29</sup> Aderuar me ligjin nr. 10397, datë 17.3.2011

<sup>30</sup> Aderuar me ligjin nr. 10398, datë 17.3.2011

<sup>31</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 10071, datë 9.02.2009

<sup>32</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 10424, datë 02.06.2011

<sup>33</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 10425, datë 02.06.2011

<sup>34</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 150/2015

- Kodi Penal, Neni 124/b “Keqtrajtimi i të Miturit”
- Kodi Penal, Neni 117 “Pornografia”
- Ligji nr. 8610, datë 17.5.2000 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave”
- Ligji nr.8920, datë 11.07.2002 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional dhe dy protokolleve shtesë”
- Ligji nr. 9265, datë 29.07.2004 ”Për ratifikimin e Konventës Evropiane ”Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”
- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar
- Ligji nr 108/2014 ” Për policinë e shtetit”, të ndryshuar
- Ligji nr. 108/2013 “Për të Huajt”, të ndryshuar
- Ligji nr. 121/2014 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”
- Ligji nr. 10173, datë 22.10.2009 “Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë”, të ndryshuar
- Ligj nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e Pastrimit të Parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar
- Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar
- Ligji nr. 111/2017 “ Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
- Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr.18/2017, datë 23.02.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- Ligji nr. 10 383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar
- Vendimi nr. 195, datë 11.04.2007 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Standardeve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Personat e Trafikuar ose në Rrezik Trafikimi në Qendrat Rezidenciale”
- Vendimi nr. 933, datë 2.07.2008 i Këshillit të Ministrave ”Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë dhe Europol”, të ndryshuar
- Udhëzimin e Përbashkët Nr. 3799, datë 8.7.2014 “Për Ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për Identifikimin, Referimin, Mbrojtjen dhe Riintegrimin e Viktimave/viktimave të Mundshme të trafikimit”
- Udhëzimi nr. 316, datë 10.2.2010, i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi”
- Urdhri nr. 293 , datë 04.06 2015, i Ministrit të Punëve të Brendshme “Për trajtimin e shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në territorin e RSH-së”
- Urdhër-Shërbimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr. 871, datë 27.12.2007 “Për procedurat që kryhen në kufi për intervistimin e shtetasve të huaj dhe shqiptarë të kthyer nga vendet e tjera”
- Memorandumi i Mirëkuptimit i Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Prezencës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunimin në Europë në Shqipëri (OSCE) “Për promovimin dhe zbatimin e Kodit të Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Turizëm” (nënshkruar në vitin 2007)

- Marrëveshja e Bashkëpunimit për Funkcionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të personave (MKR), e firmosur më datë 15 qershor, 2012

## **6. SHPJEGIME TË PËRGJITHSHME MBI PROCEDURAT DHE ORGANIZIMIN E MËTEJSHËM TË DOKUMENTIT**

Identifikimi dhe reagimi fillestar

1. Përkufizimi dhe përgjegjësitë
2. Hapat sipas sektorëve

Identifikimi formal

1. Përkufizimi dhe përgjegjësitë
2. Hapat sipas Sektorëve

Planifikim dhe Mbështetje për Riintegrim

1. Përkufizimi dhe Përgjegjësitë
2. Hapat sipas Sektorëve

Planifikim dhe Mbështetje për kthim vullnetar të asistuar

1. Përkufizimi dhe Përgjegjësitë
2. Hapat sipas Sektorëve

Mbështetje e hetimit dhe dënimit të trafikantëve

1. Përkufizimi dhe Përgjegjësitë
2. Hapat sipas Sektorëve

Formatet

# Identifikim dhe reagim fillestar

## 1. Përkufizimi dhe Përgjegjësitë

- **“Identifikim dhe Reagim Fillestar”**, është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore, vendore dhe qëndrore, përgjegjëse për mbrojtjen e personave të trafikuar në kufijtë, brenda dhe jashtë territorit të RSH-së, që përcaktojnë se një person i/e mitur apo i/e rritur është viktimë e mundshme e trafikimit të personave. Këto veprime duhet të përfshijnë: 1. vlerësimin e situatës së personave kundrejt treguesve të trafikimit 2. vlerësimin e potencialit/ mundësive të institucionit/organizatës për ta nxjerrë menjëherë personin nga situata e shfrytëzimit 3. ndërhyrjen për ta nxjerrë menjëherë personin nga situata e shfrytëzimit/ndërprerjen e shfrytëzimit (vetë apo nëpërmjet punonjësve të policisë së shtetit) 4. informimin e personit për gjykimin e punonjësit mbi situatën e tij/saj, të drejtat dhe ndihmën që mund të japë vetë institucioni për viktimat e mundshme të trafikimit dhe viktimat e trafikimit ose mënyrat e qasjes tek ndihma e institucioneve të mbrojtjes së viktimave 5. njoftimin e Anëtarit Përkates të Autoritetit Përgjegjës (APAP) ose drejtuesit/Kryesuesit të Autoritetit Përgjegjës (D/KAP) dhe komunikimin me të lidhur me vendosjen e personit në një mjedis të sigurt që i plotëson nevojat e tij/saj të menjëhershme 6. mbështetjen e vendosjes së personit në një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm 7. vlerësimi i situatës shëndetësore dhe referimi tek strukturat shëndetësore 8. plotësimin e dokumentacionit të identifikimit fillestar dhe dërgimin e tij tek APAP 8. mbështetjen e procesit të identifikimit formal 9. mbështetjen e hetimit dhe kapjes së trafikantëve 10. vijimësinë e mbrojtjes.
- **Agjencitë/institucionet përgjegjëse**, në kufijtë e RSH-së agjencia përgjegjëse për identifikim fillestar është Policia e Kufirit (të gjelbër dhe blu). Në territorin e RSH-së agjencitë përgjegjëse për identifikim fillestar janë agjencitë shtetërore dhe joshtetërore, përfshirë: KKSAT, qendrat e përkujdesjes shoqërore për persona në nevojë, organizatat me programe të ndihmës për persona në nevojë, zyrat rajonale të shërbimit social shtetëror në qarqe, strukturat e policisë së shtetit, inspektoriati shtetëror i punës, shkollat dhe institucionet arsimore, institucionet e kujdesit shëndësor, strukturat e shërbimeve sociale në bashki. Jashtë territorit të RSH-së, agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit me shtetësi shqiptare, janë punonjësit e përfaqësive diplomatike të RSH-së, si dhe agjenci të tjera shtetërore dhe joshtetërore me veprimtari në fushën e mbrojtjes së viktimave të trafikimit.

## 2. Hapat sipas sektorëve

POLICIA E SHTETIT

DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN

VEPRIMET NË KUFIT

- **Treguesit për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit**

Fëmijët	Të rriturit
<ul style="list-style-type: none"> <li>• I mituri ka kaluar kufirin ose është në tentativë për të kaluar kufirin në mënyrë të parregullt/lëvizjet kanë shmangur kontrollin kufitar;</li> <li>• I mituri është i/e shoqëruar nga persona të cilët janë të dyshuar si kontrabandistë apo trafikantë;</li> <li>• I mituri nuk posedon dokumenta/dokumentat e fëmijës janë false ose të dyshimta;</li> <li>• I mituri duket më i vjetër/më i ri se të dhënat në pasaportë;</li> <li>• I mituri nuk di adresën ku do banojë;</li> <li>• I mituri ka numra telefoni taksish;</li> <li>• I mituri shqiptar ka një histori lëvizjesh të shpeshta me ose pa familjen brenda dhe jashtë vendit;</li> <li>• I mituri udhëton në grup me persona që nuk janë të afërm dhe nuk ka prokurë nga prindërit/kujdestari ligjor;</li> <li>• I mituri udhëton me dokumentat e dikujt tjetër;</li> <li>• I mituri vjen nga vende të njohura për trafikimin;</li> <li>• I mituri ka plagë ose shenja në duar në paraqitje që tregon se ai/ajo punon;</li> <li>• I mituri ka veshur rroba të papërshtatshme për moshën e tij;</li> <li>• I mituri ka sjellje të papërshtatshme për moshën e tij/saj, sillet si më i/e rritur;</li> <li>• I mituri ka bagazhe që nuk korrespondojnë me qëllimin e udhëtimit;</li> <li>• I mituri nuk është i/e rregjistruar në gjendjen civile;</li> <li>• I mituri shfaq frikë, është i/e tërhequr;</li> <li>• I mituri shfaq mosbesim tek autoritetet;</li> <li>• I mituri ndihet i qetë kur bie në kontakt me policinë;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Personi që hyn apo që del, ka kaluar kufirin, ose është në tentativë për të kaluar kufirin në mënyrë të parregullt/lëvizjet kanë shmangur kontrollin kufitar;</li> <li>• Personi që del është i/e shoqëruar nga persona, të cilët janë të dyshuar si kontrabandistë apo trafikantë;</li> <li>• Personi që po hyn nuk ka dokument udhëtimi për shkak se është mbajtur nga punëdhënësi, personi me të cilin ka banuar etj;</li> <li>• Personi nuk di adresën ku do banojë;</li> <li>• Personi ka numra telefoni taksish;</li> <li>• Personi ka plagë;</li> <li>• Personi ka bagazhe që nuk korrespondojnë me qëllimin e udhëtimit.</li> <li>• Personi gjatë intervistës është kontradiktor me thëniet.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fshehje e statusit të emigrimit;</li> <li>• Histori të njëjta (sikur të instruktura);</li> <li>• Lejon të tjerët të flasin për të edhe pse mund ketë moshën ose paraqitjen për t'u përgjigjur vetë;</li> <li>• Janë super të shkathët dhe të zgjuar (i mituri jep përgjigje të cilat tregojnë shkathtësi dhe zgjuarsia të veçantë për moshën)</li> </ul>	
---	--

### HAPAT PËR TË MITURIT

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/ frontline dhe afatet</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/ frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (përfshirë APAP të tjerë dhe afatet)</b>
Në rast dyshimi bazuar tek treguesit për identifikimin fillestar, roja kufitare dërgon menjëherë për intervistë në vijën e dytë personin e dyshuar si të trafikuar.	Hedhja e të dhënave në sistem TIMS		
Roja kufitare njofton menjëherë përgjegjës të turnit dhe/ose/specialistin e hetimit dhe e informon për gjetjet.	Formati A.5	APAP orienton punonjës të lidhje me hapat që duhet të ndërmerren	
Në rast se i mituri/e mitura është i/e huaj, përgjegjësi i turnit dhe/ose/specialisti i hetimit merr menjëherë masa për sigurimin e përkthyesit.	Formati Z.1		
Në rast se konstaton se i mituri/e mitura ka nevojë për ndihmë të menjëhershme mjekësore, përgjegjësi i turnit dhe ose/specialisti i hetimit njofton menjëherë shërbimin shëndetësor më të afërt.	Formati A.5		Qendra shëndetësore më e afërt trajton pa vonesë të miturit/ të miturën
Përgjegjësi i turnit dhe/ose/specialisti i hetimit siguron menjëherë komunikimin me familjen dhe përmbushjen e nevojave bazë të të miturit, si dhe njofton shefin e stacionit të policisë kufitare dhe NJMF-në më të afërt, për të marrë pjesë në procesin e intervistimit të të miturit/miturës.	Formati A.5		Një vlerësim emergjent i situatës zhvillohet në vendin e origjinës/ në familjen e të miturit/të miturës nga punonjësi i policisë dhe nga

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/ frontline dhe afatet</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/ frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (përfshirë APAP të tjerë dhe afatet)</b>
			NJMF, që ndodhet pranë vendbanimit të familjes
Në rast se i/e mitura është i/e huaj, përgjegjësi i turnit dhe/ose/specialisti i hetimit, menjëherë/para fillimit të intervistës, nënshkruan me përkthyesin marrëveshjen e konfidencialitetit.	Hapi dokumentohet me formatin A.5 dhe Z.1		
Përgjegjësi i turnit dhe/ose/specialisti i hetimit zhvillon intervistën me të miturin/miturën së bashku me NJMF dhe prindin/kujdestarin ligjor, nëse janë të pranishëm dhe nuk dyshohet të jenë të përfshirë në trafikimin apo shfrytëzimin e tij. Bën vlerësimin e parë të nevojave të të miturit përfshirë vlerësimin e rrezikut nëse ka, nga familjarët e të miturit/ të miturës apo persona të tjerë.	Hapi dokumentohet në formatin A.5 dhe shënimet në formatin e intervistës për fëmijë A.2		NJMF siguron pjesëmarrjen gjatë intervistës dhe ndjek rastin. Në rast vlerësimi të nivelit të rrezikut të lartë dhe të menjëhershëm, me propozim të PMF dhe vendim të Strukturës përkatëse për shërbimet shoqërore në bashki, fëmija merret në mbrojtje të menjëhershme dhe vendoset në përkujdesje alternative. Në rast se i mituri do të referohet në një qendër emergjence/rezidenciale, NJMF njofton një nga qendrat më të afërta të emergjencës
Pas përfundimit të intervistës, përgjegjësi i turnit dhe/ose/specialisti i hetimit plotëson proces-verbalin e dorëzimit të të miturit tek NJMF/ prindi/kujdestari ligjor në rast se nuk janë	Hapi dokumentohet në formatin A.5 dhe në Z.5 ose Z.6		



<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/ frontline dhe afatet</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/ frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (përfshirë APAP të tjerë dhe afatet)</b>
të përfshirë në trafikim ose tek ofruesi i shërbimit anëtar i MKR-së.			
Në varësi të vendimit të marrë, përgjegjësi i turnit e jep/ dorëzon fëmijën: në përgjegjësinë e PMF-së ose institucionit të dërguar nga AP-ja ( institucioni) ose familjes.	Hapi dokumentohet në formatin A.5 dhe në Z.5 ose Z.6		PMF-ja komunikon me drejtuesin e sektorit
Përgjegjësi i turnit dhe/ose/specialisti i hetimit në fund të turnit harton njoftimin për mbrojtjen/identifikimin dhe ia dërgon atë në rrugë elektronike APAP-it.	Format i njoftimit mbi identifikimin fillestar A.5 TIMS Rregjistri kombëtar elektronik për të huajt	APAP ia përcjell atë Sekretariatit të AP.	
Përgjegjësi i turnit dhe/ose/specialisti i hetimit njofton menjëherë Drejtorinë Vendore të Policisë/Strukturat Vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm dhe anëtarin e AP-së, duke ia dërguar më pas informacionin me shkrim. Strukturat Vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm, pas marrjes së informacionit, kryejnë të gjitha procedurat përkatëse për vlerësimin dhe verifikimin e informacionit dhe informojnë APAP.	Informacion me shkrim	APAP ia përcjell atë sekretariatit të AP-së Afati: Menjëherë	

#### HAPAT PËR TË RRITURIT

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/ frontline (dhe afatet)</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/ frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>

Në rast dyshimi, bazuar në treguesit e identifikimit fillestar, roja kufitare dërgon menjëherë për intervistë në vijën e dytë personin e dyshuar.	Hedhja e të dhënave në sistem TIMS Hapi dokumentohet në formatin A.5	APAP orienton punonjësën në lidhje me hapat që duhet të ndërmarrin për trajtimin e rastit	
Në rast se i rrituri/ e rritura është i/e huaj, përgjegjësi i turnit dhe/ose/specialisti i hetimit, menjëherë/para fillimit të intervistës, nënshkruan me përkthyesin marrëveshjen e konfidencialitetit.	Hapi dokumentohet në formatin A.5 Hapi dokumentohet në formatin A. dhe në Deklaratën e Konfidencialitetit të përkthyesit ( Format Z.1)		
Në rast se konstaton se i rrituri/ e rritura ka nevojë për ndihmë të menjëhershme mjekësore, përgjegjësi i turnit dhe/ose/specialisti i hetimit njofton menjëherë shërbimin shëndetësor më të afërt.	Hapi dokumentohet në formatin A.5		Qendra shëndetësore trajton të rriturin/të rriturën.
Intervistuesi zhvillon intervistën dhe bën vlerësimin e parë të nevojave përfshirë vlerësimin e rrezikut; Në rast se i rrituri rezulton viktimë e mundshme e trafikimit sipas treguesve, njofton menjëherë DRSHSSH dhe punonjësën e strukturave vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm.	Hapi dokumentohet në formatin A.5 dhe shënimet në formatin e intervistës (Formati Z.3 struktura e intervistës për të rriturit)		
Përgjegjësi i turnit ose specialisti i hetimit informon personin mbi ndihmën që mund t'i jepet, ndihmon në komunikimin me punonjësën e qendrës rezidenciale nëse është paraqitur dhe në varësi të vendimit të përsosur : <i>Për personin që vendos të shkojë në një qendër të mbrojtur:</i> informon personin dhe komunikon me punonjësën e qendrës lidhur me hapat e nevojshme të mbrojtjes. <i>Për personin që vendos të shkojë në familjen e vet:</i> i jep personit informacion se si mund të aksesojë ndihmën e nevojshme.	Hapi dokumentohet në formatin A.5 dhe në Formatin Z.4 deklaratë e vendimit të informuar për ndihmën		

Në fund të turnit, përgjegjësi i turnit ose specialisti i hetimit që ka kryer intervistën fillestare harton njoftimin për identifikimin dhe ia dërgon atë në rrugë elektronike APAP-it dhe hedh të dhënat në sistemin TIMS	Format i njoftimit mbi identifikimin fillestar A.5 TIMS Rregjistri kombëtar elektronik për të huajt		
Përgjegjësi i turnit dhe/ose/specialisti i hetimit njofton menjëherë Drejtorinë Vendore të Policisë/Strukturat Vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm dhe anëtarin e AP-së, duke ia dërguar më pas informacionin me shkrim. Strukturat Vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm, pas marrjes së informacionit, kryejnë të gjitha procedurat përkatëse për vlerësimin dhe verifikimin e informacionit dhe informojnë APAP.	Informacion me shkrim	APAP ia përcjell atë sekretariatit të AP-së Afati: Menjëherë	

## VEPRIMET NË TERRITOR

- **Treguesit për identifikimin në territor të viktimave të mundshme të trafikimit**

Fëmijët	Të rriturit
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hyrja e fëmijës ka qenë e parregullt, jo nëpërmjet pikës së kalimit të kufirit;</li> <li>• Hyrja e fëmijës është lehtësuar nga persona, të cilët e kanë punësuar ose e përdorin shfrytëzojnë fëmijën;</li> <li>• I mituri është i pashoqëruar ose është i ndarë/i mituri ka hyrë pa prindërit ose është lënë vetëm pas hyrjes në territor, ose ka hyrë vetëm, ose i pashoqëruar dhe është me të afërm të tij/saj;</li> <li>• Dikush që kujdeset për fëmijën, pretendon se e ka gjetur pa përkrahje e do ta ndihmojë;</li> <li>• Personi që kujdeset për të është i/e dyshuar si trafikant ose kontrabandist fëmijësh;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hyrja e personit në territor dhe qëndrimi i tij/saj është lehtësuar nga persona, të cilët e kanë punësuar ose e përdorin personin;</li> <li>• Personi tregon një histori të hyrjes në Shqipëri të dëgjuar më parë sikur të instruktuar;</li> <li>• Dokumentet e hyrjes dhe qëndrimit të personit janë false ose të skaduara për shkaqe jashtë kontrollit të personit;</li> <li>• Hyrja e personit në Shqipëri është lehtësuar nga agjenci me rekorde të dyshimta;</li> <li>• Hyrja e personit ka qenë e parregullt – jo nëpërmjet pikës së kalimit të kufirit.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka dokumente që të provojnë lidhjen mes fëmijës dhe shoqëruesit;</li> <li>• I mituri tregon një histori të dëgjuar më parë (sikur është instruktuar);</li> <li>• I mituri nuk posedon dokumente/dokumentet janë false/të dyshimta ose i kanë skaduar;</li> <li>• I mituri kryen aktivitet ekonomik të paligjshëm, ai/ajo punon kur nuk ka moshën e lejuar për punë, apo kryen punë të cilat janë të rrezikshme, punë nate, etj.;</li> <li>• I rrituri që kujdeset për fëmijën, me të cilin i mituri jeton, nuk ka bërë përpjekje për të rregulluar qëndrimin e fëmijës ose i është shmangur rregullimit të qëndrimit;</li> <li>• I mituri qëndron me individë apo grupe të dyshuara për aktivitete të paligjshme;</li> <li>• I mituri punon në punë të rrezikshme, natën;</li> <li>• I mituri që mund të kujdeset vetë për dokumentin e tij/saj, nuk e posedon atë;</li> <li>• I mituri ka gjendje shëndetësore të keqe, si rezultat i veprimtarisë ekonomike që kryen dhe rezultat i mostrajtitimit (keq ushqyerje, mos ushqyerje, etj);</li> <li>• I mituri shfaq frikë, është i/e tërhequr;</li> <li>• I mituri ka mosbesim tek autoritetet;</li> <li>• Lejon të tjerët të flasin për të edhe pse mund ketë moshën ose paraqitjen për t'u përgjigjur vetë.</li> </ul>	
---	--

### HAPAT PËR TË MITURIT

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/ frontline (dhe afatet)</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/ frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë ( jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>

Nëse dyshon për një rast trafikimi bazuar në indikatorët e identifikimit fillestar, punonjësi i policisë kufitare dhe migracionit lidhet menjëherë me APAP-in dhe njofton PMF/NJMF, e cila mbulon territorin ku është identifikuar fëmija.	Hapi dokumentohet në formatin A.5	Orienton punonjësin për referimin e rastit.  Me marrjen e formatit njofton Sekretariatit e AP	
Në rast se konstaton se i mituri/e mitura ka nevojë për ndihmë të menjëhershme mjekësore, njofton menjëherë shërbimin shëndetësor më të afërt.	Hapi dokumentohet në formatin A.5		Qendra shëndetësore më e afërt trajton pa vonesë të miturin/ të miturën
Siguron menjëherë komunikimin me familjen dhe përmbushjen e nevojave bazë të të miturit.	Hapi dokumentohet në formatin A.5		
Punonjësi i policisë kufitare dhe migracionit zhvillon intervistën me të miturin/miturën dhe bën vlerësimin e parë të nevojave të tij/saj, vlerësimin e rrezikut nëse fëmija është: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fëmijë viktimë e mundshme trafikimi;</li> <li>• Fëmijë i pashoqëruar në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare;</li> <li>• Fëmijë i pashoqëruar në nevojë për mbrojtje;</li> <li>• Fëmijë në nevojë për mbrojtje: i abuzuar , i dhunuar</li> </ul> Pas kryerjes së veprimeve të mësipërme, ndërpret intervistën dhe njofton menjëherë NJMF-në dhe punonjësin e policisë për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm pranë DPQ.	Hapi dokumentohet në formatin A.5 dhe A.2		
Në rast se i mituri është i huaj, punonjësi i policisë kufitare dhe migracionit, nis procedurat për sigurimin e lejes së qëndrimit për të miturin/miturën <sup>35</sup> .	Dokumentimi i lejes së përkohshme “A” ose lejes së qëndrimit “B” nga Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin për të miturin/miturën. Njofton me e-mail	APAP informon Sekretariatit e AP-së mbi hapat që janë ndërmarrë lidhur me sigurimin e lejes së qëndrimit	

<sup>35</sup> Neni 54 i Ligjit 108/2013 “Për të huajt”

	APAP		
Me përfundimin e intervistës, punonjësi i policisë kufitare dhe migracionit krijon kushtet për një mbledhje/diskutim të vlerësimit të interesit më të lartë të fëmijës, me pjesëmarrjen e fëmijës vetë nëse mosha dhe pjekuria e fëmijës e lejojnë këtë, të prindit ose kujdestarit të fëmijës	Hapi dokumentohet në formatin A.5 dhe Formati Z3 )		
Në varësi të vendimit, punonjësi i policisë kufitare dhe migracionit e dorëzon fëmijën për kujdes tek: PMF-ja ose institucioni i dërguar nga AP-ja , ose familja.	Hapi dokumentohet në formatin A.5 dhe Z.5	APAP komunikon me institucionin për dërgimin e përfaqësuesve	
Në fund të turnit, punonjësi i policisë kufitare dhe migracionit që ka kryer intervistën fillestare harton njoftimin për identifikimin dhe ia dërgon atë në rrugë elektronike APAP-it dhe hedh të dhënat në sistemin TIMS.	Format i njoftimit mbi identifikimin fillestar A.5 TIMS Rregjistri kombëtar elektronik për të huajt	APAP ia përcjell atë Sekretariatit të AP-së	
Përgjegjësi i turnit dhe/ose/specialisti i hetimit njofton menjëherë Drejtorinë Vendore të Policisë/Strukturat Vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm dhe anëtarin e AP-së, duke ia dërguar më pas informacionin me shkrim. Strukturat Vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm, pas marrjes së informacionit, kryejnë të gjitha procedurat përkatëse për vlerësimin dhe verifikimin e informacionit dhe informojnë APAP.	Informacion me shkrim	APAP ia përcjell atë sekretariatit të AP-së Afati: Menjëherë	

#### HAPAT PËR TË RRRITURIT

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/ frontline (dhe afatet)</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/ frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>

Nëse dyshon për një rast trafikimi bazuar në indikatorët e identifikimit fillestar, punonjësi i policisë kufitare dhe migracionit lidhet menjëherë me APAP-in.	Hapi dokumentohet në formatin A.5	Orienton punonjësin për referimin e rastit.  Me marrjen e formatit njofton Sekretariatit e AP	
Në rast se konstaton se i rrituri/ e rritura ka nevojë për ndihmë të menjëhershme mjekësore, njofton menjëherë shërbimin shëndetësor më të afërt	Hapi dokumentohet në formatin A.5		Qendra shëndetësore më e afërt trajton pa vonesë të rriturin/ të rriturën
Punonjësi i policisë kufitare dhe migracionit zhvillon intervistën me të rriturin/riturën dhe bën vlerësimin e parë të nevojave të të rriturit përfshirë vlerësimin e rrezikut nëse ka, nga familjarët e të rriturit/ të rriturës apo persona të tjerë. Pas kryerjes së veprimeve të mësipërme, njofton menjëherë SHSSHR dhe punonjësin e policisë për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm pranë DPQ për referimin e rastit.	Hapi dokumentohet në formatin A.5 dhe shënimet në formatin e intervistës (Formati Z.3 struktura e intervistës për të rriturit)		
Në rast se viktimë/viktima e mundshme e trafikimit, është i/e huaj, punonjësi i policisë kufitare dhe migracionit nis procedurat për sigurimin e lejes së qëndrimit për të <sup>36</sup> .	Dokumentimi i lejes së përkohshme “A” ose lejes së qëndrimit “B” nga Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin për viktimën e mundshme të trafikimit Njofton me e-mail APAP	APAP informon Sekretariatit e AP-së mbi hapat që janë ndërmarrë lidhur me sigurimin e lejes së qëndrimit	
Në fund të turnit, punonjësi i policisë kufitare dhe migracionit harton njoftimin për identifikimin dhe ia dërgon atë në rrugë elektronike APAP-it dhe hedh të dhënat në sistemin TIMS.	Format i njoftimit mbi identifikimin fillestar A.5 TIMS Regjistri kombëtar elektronik për të huajt	APAP ia përcjell atë Sekretariatit të AP.	

<sup>36</sup> Neni 54 i Ligjit 108/2013 “Për të huajt”

<p>Përgjegjësi i turnit dhe/ose/specialisti i hetimit njofton menjëherë Drejtorinë Vendore të Policisë/Strukturat Vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm dhe anëtarin e AP-së, duke ia dërguar më pas informacionin me shkrim. Strukturat Vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm, pas marrjes së informacionit, kryejnë të gjitha procedurat përkatëse për vlerësimin dhe verifikimin e informacionit dhe informojnë APAP.</p>	<p>Informacion me shkrim</p>	<p>APAP ia përcjell atë sekretariatit të AP-së Afati: Menjëherë</p>	
--	------------------------------	---	--

### STRUKTURAT E TJERA TË POLICISË SË SHTETIT

**•Treguesit për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit**

<p><b>Fëmijët</b></p>	<p><b>Të rriturit</b></p>
-----------------------	---------------------------



<ul style="list-style-type: none"> <li>• I mituri/e mitura është i/e sjellë nga një vend tjetër për të punuar/fituar më shumë para;</li> <li>• I mituri/e mitura ka lëvizur i/e peregjistruar në gjendjen civile;</li> <li>• I mituri/e mitura largohet shpesh nga shtëpia;</li> <li>• I mituri/e mitura vetë, prindërit e tij/saj dhe motra vëllezër kanë ardhur shpesh në kontakt me policinë si pasojë e ekspozimit, pësimit të dhunës;</li> <li>• I mituri/e mitura ka një numër të kufizuar kontaktesh;</li> <li>• I mituri/e mitura kalon pjesën më të madhe të kohës në rrugë duke shitur, duke lypur, duke punuar;</li> <li>• Fëmijës i merren të ardhurat nga lypja, puna, veprimtaria nga më të rriturit;</li> <li>• I mituri/e mitura është kapur duke kryer veprimtari të paligjshme dhe dyshohet se ka të tjerë më të rritur që e shtyjnë;</li> <li>• I mituri/e mitura është i/e punësuar në mënyrë të paligjshme apo punon në punë të rrezikshme;</li> <li>• I mituri/e mitura ka kontakte me individë apo grupe të dyshuara për aktivitete të paligjshme;</li> <li>• I mituri/e mitura shfaq frikë, është i/e tërhequr;</li> <li>• I mituri/e mitura ka mosbesim tek autoritetet;</li> <li>• I mituri/e mitura tregon histori të ngjashme dukshëm të mësuara;</li> <li>• Lejon të tjerët të flasin për të edhe pse mund ketë moshën ose paraqitjen për t'u përgjigjur vetë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Personi është sjellë nga një vend tjetër për të punuar/fituar më shumë para;</li> <li>• Personi ka një numër të kufizuar kontaktesh;</li> <li>• Personi është i punësuar në mënyrë të paligjshme/punon në punë të rrezikshme;</li> <li>• Personi ka kontakte me individë apo grupe të dyshuara për aktivitete të paligjshme;</li> <li>• Shtrengohen të punojnë në kushte të caktuara;</li> <li>• Vijnë nga një vend i njohur si vend origjine;</li> <li>• Nuk janë në gjendje të tregojnë dokumentat e identitetit;</li> <li>• Lejojnë të tjerët të flasin për ta;</li> <li>• Janë të paaftë të komunikojnë lirshëm me të tjerët;</li> <li>• Shfaqin ankth dhe frikë gjatë komunikimit;</li> <li>• Nuk kanë akses te shërbimi mjekësor.</li> </ul>
--	---

### HAPAT PËR TË MITURIT

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/ frontline (dhe afatet)</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/ frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
---	--	--	---

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/ frontline (dhe afatet)</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/ frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
Punonjësi i policisë bie në kontakt me një fëmijë dhe arrin në konkluzionin se situata e tij/saj ka tregues të trafikimit të fëmijëve <sup>37</sup> .	Hapi dokumentohet në formatin A.5		
Bën një vlerësim të nevojave të viktimës së mundshme të trafikimit, ofron dhe aplikon ndihmë e mbrojtje të mundshme, të përshtatshme dhe të pranuar vullnetarisht nga viktimat e mundshme të trafikimit, si dhe prindi apo kujdestari ligjor ( <i>nëse gjykon se prindi apo kujdestari nuk është përfshirë në trafikim apo vepër penale tjetër</i> ).	Hapi dokumentohet në formatin A.5		
Informon viktimën e mundshme të trafikimit, së bashku me prindin apo kujdestarin ligjor ( <i>nëse gjykon se prindi apo kujdestari nuk është përfshirë në trafikim</i> ) për mundësitë e ndihmës për viktimat e trafikimit, përfshirë mundësitë që jep identifikimi formal.	Hapi dokumentohet në formatin A.5		
Nëse në komunikimin me fëmijën deri në këtë moment nuk ka pasur punonjës social ose psikolog, të policisë apo institucioneve të tjera të vënë në dispozicion për intervistimin e fëmijëve ose përkthyes nëse fëmijë është i/e huaj, drejtuesi i stacionit të policisë komunikon me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në bashki dhe kërkon pjesëmarrjen e një PMF-je në intervistimin e fëmijës.	Hapi dokumentohet në formatin A.5 dhe deklaratën e konfidencialitetit Z.1		Strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në bashki dërgojnë një PMF.

<sup>37</sup> Fëmija mund të jetë jashtë ambienteve të policisë ose në ambientet e policisë. Punonjësi i policisë është duke intervistuar një fëmijë, i cili është kapur duke kryer një aktivitet të paligjshëm

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/ frontline (dhe afatet)</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësiti në bazë/ frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësiti kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
<p>Punonjësi i policisë që ka shoqëruar fëmijën ose një punonjës tjetër i policisë i vendosur nga drejtuesi i stacionit <i>zhvillon intervistën fillestare të fëmijës ose aplikon diferencialin</i> së bashku me PMF-në dhe me punonjësini social ose psikologun e strukturave të policisë dhe në prani të prindit, nëse nuk ka informacion se prindi është i/e përfshirë në trafikim, në shkeljen e të drejtave të fëmijës apo në kryerjen e veprës apo kundravajtjes penale nga fëmija apo që prania e tij nuk ndikon në gjendjen e tij emocionale.</p>	<p>Intervista për fëmijë A.2 ose Diferenciali A.3</p>		
<p>Me përfundimin e intervistës, punonjësi i policisë krijon kushtet për një mbledhje/diskutim të vlerësimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe së bashku me PMF, psikologun ose punonjësini social, me prindin apo kujdestarin ligjor nëse janë të pranishëm, marrin në shqyrtim gjetjet e intervistës dhe marrin vendim për reagimin e menjëhershëm/ masat e mbrojtjes.</p>	<p>Hapi dokumentohet në formatin A.5 dhe tek Formatin i dokumentimit të shqyrtimit dhe vendimit në interesin më të lartë të fëmijës (Formati Z.3)</p>		
<p>Punonjësi i policisë dorëzon fëmijën për kujdes/veprime të mëtejshme tek PMF-ja dhe kryen të gjitha veprimet për të cilat është marë vendim së bashku. Ndërsa, jashtë orarit zyrtar njofton shërbimin e mbrojtjes emergjente 24 orësh sipas legjislacionit përkatës.</p>	<p>Hapi dokumentohet në formatin A.5 dhe tek Z.5</p>		<p>PMF-ja e jep më pas fëmijën tek prindërit, kujdestarë, apo e vendos në kujdes emergjent apo alternativ</p>
<p>Në fund të turnit, punonjësi i policisë që ka kryer intervistën fillestare, harton njoftimin për identifikimin dhe ia dërgon atë në rrugë elektronike APAP-it.</p>	<p>Formati i njoftimit mbi identifikimin fillestar A.5</p>	<p>APAP ia përcjell atë Sekretariatit të AP-së</p>	

## HAPAT PËR TË RRITURIT

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/frontline (dhe afatet)</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë) dhe afatet</b>
Nëse gjatë intervistimit, punonjësi i policisë vëren apo konstaton tregues të trafikimit, vlerëson situatën dhe jep gjykimin e tij profesional nëse ka të bëjë me një rast të një viktime të mundshme trafikimi.	Hapi dokumentohet në Formulari A.5		
Bën një vlerësim të nevojave të viktimës së mundshme të trafikimit, ofron dhe aplikon ndihmë e mbrojtje të mundshme, të përshtatshme dhe të pranuar vullnetarisht nga viktimat e mundshme e trafikimit.	Hapi dokumentohet në Formulari A.5		
Informon viktimën e mundshme të trafikimit për mundësitë e ndihmës për viktimat e trafikimit, përfshirë mundësitë që jep identifikimi formal	Hapi dokumentohet në Formulari A.5		
Punonjësi i policisë e fton ose e shoqëron personin që nuk është në ambientet e policisë të shkojë në ambientet e policisë për intervistë fillestare ose formale.	Hapi dokumentohet në Formulari A.5 nëse ndodh		
Nëse personi nuk dëshiron të intervistohet nga policia, punonjësi i policisë i jep personit kontaktet ose e udhëzon të drejtohet tek shërbimi social shtetëror ose shërbimi social lokal/i bashkisë dhe njofton menjëherë sektorin e trafiqeve të paligjshme, duke i kaluar të gjithë informacionin e nevojshëm për lokalizimin e personit dhe trafikantëve të dyshuar.	Hapi dokumentohet në Formulari A.5		
Nëse viktimat e mundshme e trafikimit, jep pëlqimin për identifikimin formal, plotëson dhe dërgon “Kërkesën për identifikim formal” tek Seksioni për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm pranë DPQ për organizimin e intervistës për identifikim formal, në kohën më të përshtatshme të vendosur nga viktimat e mundshme e trafikimit.	Hapi dokumentohet në Formulari A.5		

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/frontline (dhe afatet)</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë) dhe afatet</b>
Nëse viktimat e mundshme të trafikimit është shtetas i huaj dhe kërkohet prania e përkthyesit, plotësohet “ <i>Deklarata e Konfidencialitetit</i> ”.	Hapi dokumentohet në Formularin A.5 dhe Z.1		
Punonjësi i policisë informon personin mbi ndihmën që mund ti jepet, ndihmon në komunikimin me punonjësin e qendrës rezidenciale nëse është paraqitur dhe në varësi të vendimit të personit: <i>Për personin që vendos të shkojë në një qendër të mbrojtur:</i> informon personin dhe komunikon me punonjësin e qendrës lidhur me hapat e nevojshme të mbrojtjes <i>Për personin që vendos të shkojë në familjen e vet:</i> i jep personit informacion se si mund të marrë ndihmën e nevojshme.	Hapi dokumentohet në formatin A.5 dhe në Formatin Z.4 deklaratë e vendimit të informuar për ndihmën		
Në fund të turnit, punonjësi i policisë harton njoftimin për identifikimin dhe ia dërgon atë në rrugë elektronike APAP-it dhe hedh të dhënat në sistemin TIMS.	Format i njoftimit mbi identifikimin fillestar A.5 TIMS Rregjistri kombëtar elektronik për të huajt	APAP ia përcjell atë Sekretariatit të AP.	
Punonjësi i policisë harton një material me informacion të vlefshëm për hetimin dhe ia përcjell shefit të stacionit.	Hapi dokumentohet në Formatin i njoftimit mbi identifikimin fillestar A.5		

## INSTITUCIONET E SISTEMIT ARSIMOR

- **Treguesit për identifikimin e të miturve viktima/viktima të mundshme të trafikimit**

- Kanë plagë që janë rezultat i sulmit;
- Ndërrimi i shpeshtë i partnerëve;
- Lypin;
- Transportohen me makina të shtrenjta;
- Janë të përfshirë në punë që nuk janë të përshtatshme për moshën;
- Mbajnë apo shesin droga të paligjshme;
- Shoqërimi me meshkuj të rritur mbi 40 vjeç që janë marrë me trafikim;
- Shfaqin frikë ose ankth;
- Mungesë përqëndrimi në orë të mësimi;
- Komunikimi i tejzgjatur me telefon;
- Sjellje jo tipike për moshën;
- Vetëvlerësim i ulët;
- Janë objekt sharjesh, diskriminimi;
- Izolim social/nuk kanë ndërveprim social ose e kanë të limituar atë;
- Nuk komunikojnë lirshëm me të tjerët;
- Nuk kanë shokë të tyre jashtë ambientit të shkollës;
- Abuzime në familje;
- Ndjehen të veçuar nga fëmijët e tjerë të familjes;
- Mungesa e njërit prind ose e të dyve;
- Mungesë e autoritetit prindëror;
- Braktisja, largimi nga shtëpia;
- Disiplinohen nëpërmjet dënimeve;
- Kushte ekonomike të këqija;
- Veshja e ekzagjiruar për ambient shkollor;
- Telefona celulare shumë të shtrenjtë (jashtë mundësive të familjes);
- Lëvizin nga një vend në tjetrin për të punuar, nxjerrë të ardhura;
- Lënie e shpeshtë e orëve të mësimi.

## HAPAT PËR FËMIJËT DHE TË RINJTË

<b>Detyrat/hapat e mësuesit/punonjësit arsimor/punonjësit social/psikologut të shkollës dhe afatet</b>	<b>Dokumentimi nga mësuesit punonjësit arsimor/punonjësit social/psikologut të shkollës</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
<p>Nëse mësuesi/punonjësi arsimor merr informacion se një fëmijë mund të jetë në situatë trafikimi (krahason informacionin me treguesit), njofton menjëherë sipas rastit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mësuesi – psikologun ose punonjësin social të shkollës dhe drejtorin e shkollës</li> <li>• Psikologu ose punonjësi social – drejtorin e shkollës dhe mësuesin kujdestar</li> <li>• Drejtori i shkollës – psikologun ose punonjësin social dhe mësuesin kujdestar</li> </ul>	Hapi dokumentohet në Formatin A.5		
Mësuesi, psikologu ose punonjësi social dhe drejtori i shkollës vendosin së bashku se kush do ta intervistojë fëmijën (mësuesi kujdestar, një mësues tjetër, psikologu/punonjësi social) dhe nëse duhet të marrin pjesë prindërit, kujdestarët e fëmijës në intervistim.	Hapi dokumentohet në formatin A.5		
Në rast se konstaton që i mituri/e mitura ka nevojë për ndihmë të menjëhershme mjekësore, punonjësi social/psikologu njofton prindin/kujdestarin ligjor dhe e çon të miturin/të miturën menjëherë në qendrën më të afërt shëndetësore.	Hapi dokumentohet në formatin A.5		Qendra shëndetësore më e afërt trajton pa vonesë të miturin/ të miturën
Mësuesi ose psikologu, ose punonjësi social (intervistuesi i vendosur) zhvillon takimin me prindin ose kujdestarin e fëmijës dhe mbledh informacion për t'u përgatitur për intervistimin e fëmijës, si edhe merr leje për intervistimin e fëmijës.	Formulari Z.6		

<b>Detyrat/hapat e mësuesit/punonjësit arsimor/punonjësit social/psikologut të shkollës dhe afatet</b>	<b>Dokumentimi nga mësuesit punonjësit arsimor/punonjësit social/psikologut të shkollës</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
Mësuesi ose psikologu, ose punonjësi social (intervistuesi i vendosur) zhvillon intervistën me fëmijën dhe prindin ose kujdestarin.	Formulari A.2		
Për rastet të cilat nuk mund të zhvillohet një intervistë për shkak se fëmija ose prindi nuk pranon të intervistohet fëmija, apo fëmija nuk jep informacion, drejtori i shkollës komunikon me PMF dhe informon për situatën e fëmijës/kërkon ndërhyrje të menjëhershme.	Formulari A.1		
Intervistuesi njofton konkluzionet e arritura tek drejtori i shkollës dhe prindi ose kujdestari i fëmijës- prindi ose kujdestari njoftohen/ rikujtohen për detyrimin e stafit të shkollës për raportimin e abuzimit të fëmijës. <sup>38</sup>	Hapi dokumentohet nga format A.5		
Drejtori i shkollës njofton NJAV dhe kjo njofton APAP për identifikimin .	Hapi dokumentohet nga format A.5	APAP komunikon drejtpërdrejt me shkollën dhe vlerëson nevojën për përfshirjen e anëtarëve të tjerë të AP në mbrojtjen e fëmijës	
Stafi i shkollës dhe NJAV veprojnë në përputhje me vendimet e marra në interesin më të lartë të fëmijës: në rast të vazhdimit të qëndrimit në familje dhe në shkollë të fëmijës drejtori udhëzon për masa të veçanta mbrojtjeje dhe ndihme	Në varësi të vendimit – Format i Z.5		

<sup>38</sup> Neni 67, pika 3 e Ligjit 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës “Mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psiko-social shkollor kanë për detyrë të raportojnë çdo rast të dyshuar apo të ndodhur, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës në njësitë arsimore vendore ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës. Njësia arsimore vendore, në çdo rast, kur merr dijeni për fëmijë në nevojë për mbrojtje, bën raportimin te strukturat për mbrojtjen e fëmijës”



<b>Detyrat/hapat e mësuesit/punonjësit arsimor/punonjësit social/psikologut të shkollës dhe afatet</b>	<b>Dokumentimi nga mësuesit punonjësit arsimor/punonjësit social/psikologut të shkollës</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
<p>për fëmijën;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>në rast të transferimit të fëmijës përgatit dokumentacionin e nevojshëm për shpërnguljen e tij/saj pa vonesa</li> </ul>			
Drejtori i shkollës përgatit dhe dërgon në NJAV njoftimin për procesin identifikimin fillestar	Hapi dokumentohet në A.5		

## INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS

### •Treguesit për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit

<b>Fëmijët</b>	<b>Të rriturit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Vijnë nga një vend i njohur si vend origjine;</li> <li>I mituri bën punë jo të përshatshme për moshën;</li> <li>Kanë plagë ose dëmtime tipike të disa lloj punëve;</li> <li>Prindërit, kujdestarët dhe ata vetë nuk mund të negociojnë kushtet e punës;</li> <li>Janë të ekspozuar ndaj aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale;</li> <li>Janë në punë të paligjshme;</li> <li>Nuk kanë akses tek pagesat e tyre;</li> <li>Vendi i punës nuk është i pajisur me sinjalsitikën e duhur mbi rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë;</li> <li>Nuk kanë trajnimet e nevojshme apo licencat profesionale;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vijnë nga një vend i njohur si vend origjine;</li> <li>Shtrengohen të punojnë në kushte të caktuara dhe të papërshtatshme për sigurinë dhe shëndetin në punë”;</li> <li>Nuk janë në gjendje të tregojnë dokumentat e identitetit;</li> <li>Lejojnë të tjerët të flasin për ta;</li> <li>Nuk e lënë kurrë vendin e punës pa punëdhënësin;</li> <li>Punëdhënësi i kërcënon se do t’i dorëzojë tek autoritetet nëse nuk pranojnë kushtet e punës;</li> <li>Nuk lëvizin lirisht;</li> <li>Janë të paaftë të komunikojnë lirshëm me të tjerët;</li> <li>Shfaqin ankth dhe frikë gjatë komunikimit;</li> <li>Kanë bërë ankesa të ndryshme;</li> <li>Nuk njohin gjuhën e vendit ku punojnë;</li> <li>Nuk besojnë tek autoritetet;</li> <li>Marrin pak ose aspak pagesë;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk kanë kontratë individuale pune;</li> <li>• Kostot e jetesës u zbriten nga rroga;</li> <li>• Nuk kanë kontrata, kanë kontrata të paplota ose nuk u respektohen kontratat;</li> <li>• Nuk kanë akses te shërbimi mjekësor;</li> <li>• Varen nga punëdhënësi për transportin, punën, akomodimin;</li> <li>• Nuk kanë ditë pushimi;</li> <li>• Punojnë me orare të stërzgjatura;</li> <li>• Flenë aty ku punojnë;</li> <li>• Punëdhënësi ngurron të vërë në dispozicion dokumente;</li> <li>• Administratori nuk tregon rekorde të pagave;</li> <li>• Janë të ekspozuar ndaj aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale;</li> <li>• Nuk kanë akses tek pagesat e tyre;</li> <li>• Janë në punë të paligjshme;</li> <li>• Ambienti nuk ka njoftime për shëndetin apo sigurinë në punë;</li> <li>• Nuk kanë trajnimet e nevojshme apo dëshmi profesionale.</li> </ul>
--	---

### HAPAT PËR TË MITURIT

<b>Detyrat/hapat e inspektorit (dhe afatet)</b>	<b>Dokumentimi nga inspektori</b>	<b>Detyrat/hapat e APAP dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
Nëse dyshon për një rast trafikimi bazuar në indikatorët e identifikimit fillestar, punonjësi i inspektoratit të punës njofton menjëherë NJMF dhe Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Inspektoratit dhe APAP.	Hapi dokumentohet në Formatin A.5	Orienton punonjësën për referimin e rastit.	
Në rast se konstaton se i mituri/e mitura ka nevojë për ndihmë të menjëhershme mjekësore, inspektori e njofton menjëherë shërbimin shëndetësor.	Hapi dokumentohet në Formatin A.5		Qendra shëndetësore më e afërt trajton pa vonesë të miturin/të miturën

Inspektori në prani të PMF zhvillon intervistën me të miturin/miturën dhe vlerësojnë situatën e fëmijës duke përcaktuar sidomos nëse fëmija është viktimë e formave më të këqija të punës së fëmijëve përfshirë viktimë e trafikimit <b>Afati/kohëzgjatja:</b> sa është e nevojshme duke gjykuar mbi moshën dhe gjendjen e të miturit/të miturës.	Hapi dokumentohet në Formatin A.5		
Inspektori dhe drejtori informojnë APAP ose D/KAP lidhur me vendimin dhe në rast se konsiderohet e nevojshme kërkojnë dërgimin e një përfaqësuesi të ndihmës nga strehëzat.	Hapi dokumentohet në Z.4 ose Z.5		APAP ose D/KAP komunikojnë me APAP nga Ministria ose përfaqësuesin e KKSAT
Inspektori vepron në përputhje me vendimin e marrë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dorëzon fëmijën tek PMF</li> <li>• Dorëzon fëmijën tek punonjësi i strehëzës/programit që ka dërguar AP- ja</li> </ul>	Hapi dokumentohet në Z.4 ose Z.5		
Inspektori & drejtori përgatisin dhe dërgojnë në AP njoftimin për identifikimin dhe e informon për gjetjet.	Hapi dokumentohet në Formatin A.5	APAP njofton Sekretariatit e AP-së Merr masat për referimin e rastit	

#### HAPAT PËR TË RRITURIT

<b>Detyrat/hapat e inspektorit (dhe afatet )</b>	<b>Dokumentimi nga inspektori</b>	<b>Detyrat/hapat e APAP dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
Nëse dyshon për një rast trafikimi bazuar në indikatorët e identifikimit fillestar, inspektori njofton menjëherë drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Inspektoratit dhe APAP dhe e informon për gjetjet.	Hapi dokumentohet në A.5	Orienton punonjësin për referimin e rastit.	

<b>Detyrat/hapat e inspektorit (dhe afatet )</b>	<b>Dokumentimi nga inspektori</b>	<b>Detyrat/hapat e APAP dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
Në rast se konstaton se i rrituri/ e rritura ka nevojë për ndihmë të menjëhershme mjekësore, inspektori njofton menjëherë shërbimin shëndetësor.	Hapi dokumentohet në A.5		Qendra shëndetësore më e afërt trajton pa vonesë të rriturin/të rriturën
Në rast se personi është i/e huaj, Drejtori i zyrës kërkon përkthyes; Inspektori zhvillon intervistën me ndihmën e përkthyesit	Deklarata e përkthyesit A.1		
Inspektori dhe drejtori informojnë APAP ose D/KAP lidhur me vendimin dhe në rast se konsiderohet e nevojshme kërkojnë dërgimin e një përfaqësuesi të ndihmës nga strehëzat.			
Inspektori & drejtori përgatisin dhe dërgojnë në AP njoftimin për identifikimin	Hapi dokumentohet në A.5	APAP njofton Sekretariatit e AP-së Merr masat për referimin e rastit	

## INSTITUCIONET E KUJDESIT SHËNDETËSOR

### •Treguesit për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit

<b>Fëmijët</b>	<b>Të rriturit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• I mituri/e mitura nuk është nga ky vend/qytet;</li> <li>• I mituri/e mitura vjen nga një vend i njohur si vend origjine;</li> <li>• I mituri/e mitura është i/e shoqëruar nga të rritur, të cilët nuk mund të provojnë lidhjen me të;</li> <li>• I mituri/e mitura ka shenja dëmtimi në faza të ndryshme</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Personi nuk është nga vendi, vjen nga një vend i njohur si vend origjine;</li> <li>• Personi vjen i/e shoqëruar nga persona që e kontrollojnë, nuk e lënë vetëm, nuk e lënë të komunikojë me personelin shëndetësor;</li> <li>• Personi ka shenja dëmtimi në faza të ndryshme të shërimit</li> </ul>

<p>të shërimit që tregojnë se i mituri punon;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• I mituri/e mitura paraqitet me infeksione të transmetuara seksualisht dhe të patrajuara (sëmundje inflamatorë të pelvisit, barra ektope, dhimbje kronike të pelvisit);</li> <li>• I mituri/e mitura është paraqitur edhe herë të tjera me shtatëzani jashtë martesë duke kërkuar të kryejë abort;</li> <li>• I mituri/e mitura është i/e veshur keq, i/e paushqyer, i/e pakujdesur, pa gjumë të mjaftueshëm.</li> </ul>	<p>që tregojnë se personi pëson dhunë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• I/e pyetur lidhur me arsyet e mosparaqitjes tek mjeku në kohë, personi shfaq frikë dhe ankth;</li> <li>• Personi ka qenë objekt i aksidentit;</li> <li>• Personi paraqitet me infeksione të transmetuara seksualisht dhe të patrajuara: sëmundje inflamatorë të pelvisit, barra ektope, dhimbje kronike të pelvisit;</li> <li>• Personi i cili deklaron se punon dhe nuk ka sigurime shëndetësore;</li> <li>• Personi jep shenja që ka aktivitet intensiv seksual (prostituon) dhe paraqitet gjithashtu me çrregullime të personalitetit, disosacione, ankth ose depresion;</li> <li>• Personi paraqitet me dëmtime fizike të shkaktuara nga puna pa masa mbrojtëse;</li> <li>• Personi nuk kujdeset për higjenën e vet.</li> </ul>
--	---

## HAPAT PËR TË MITURIT

<b>Detyrat/hapat e stafit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor (dhe afatet)</b>	<b>Dokumentimi nga stafi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkates të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
Nëse dyshon për një rast trafikimi bazuar në indikatorët e identifikimit fillestar, personeli i shërbimeve të kujdesit shëndetësor lidhet menjëherë me Drejtorinë Rajonale Shëndetësore/Drejtorinë e Shëndetit Publik dhe informon NJMF <sup>39</sup> dhe APAP-in.	Hapi i dokumentuar në A.5	APAP është i disponueshëm për të siguruar nëpërmjet AP-së praninë e një specialisti të fëmijëve në rast të pamundësisë së PMF-së	
Siguron menjëherë përmbushjen e nevojave bazë të të miturit/miturës.	Hapi i dokumentuar në		

<sup>39</sup> Neni 51 i ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, përcakton detyrat e PMF-së që të bëjë vlerësimin e nivelit të rrezikut të çdo rasti të referuar dhe të identifikuar të fëmijës në nevojë për mbrojtje

	A.5		
<p>Stafi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor zhvillon intervistën me të miturin/miturën, në prani të NJMF/një punonjësi social, të cilët bëjnë vlerësimin e parë të nevojave të të miturit, përfshirë vlerësimin e rrezikut nëse ka, nga familjarët e të miturit/të miturës apo persona të tjerë;</p> <p><b>Afati/kohëzgjatja:</b> sa është e nevojshme duke gjykuar mbi moshën dhe gjendjen e të miturit/të miturës.</p>	Hapi i dokumentuar në A.5 dhe në formatin e intervistës A.2 Vërtetimi i statusit të identifikimit Z.2		
<p>Stafi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe PMFja, së bashku me prindin apo kujdestarin zhvillojnë mbledhjen për shqyrtimin e interesit më të lartë të fëmijës.</p>	Dokumentim i shqyrtimit dhe vendimit në interesin më të lartë të fëmijës Z.3		PMF ja, specialistë të tjerë të kujdesit shëndetësor dhe prindërit apo kujdestarët marrin pjesë në shqyrtim dhe vendimmarrje
<p>Stafi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor vepron në përputhje me vendimin e marrë duke bërë sipas rastit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Referimin dhe dërgimin e fëmijës në një institucion shëndetësor nëse e ka të nevojshme;</li> <li>Mbajtjen e fëmijës në ambientet e shërbimit deri në stabilizimin e gjendjes së tij/saj dhe vendosjes apo kthimit të tij/saj në shtëpi, vendosjes në një qendër ose zgjidhje të tjera.</li> </ul>	Hapi i dokumentuar në A.5	Në varësi të vendimit, APAP lehtëson komunikimin dhe trajtimin e fëmijës në institucionin tjetër shëndetësor	
<p>Stafi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor e dorëzon fëmijën tek PMF-ja.</p>	Formulari Z.5		PMF-ja ia jep më pas prindit ose institucionit

Punonjësi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor plotëson dhe dërgon në DRSH/DSHP dhe këta të fundit tek AP-ja me shkrim formularin A.5 dhe gjithashtu njoftimin tek NJMF- ja për fëmijën e paregjistruar, pa dokument identiteti <sup>40</sup> .	Hapi i dokumentuar në A.5	APAP e merr formularin dhe ia dërgon sekretariatit të AP-së	
---	---------------------------	---	--

### HAPAT PËR TË RRITURIT

<b>Detyrat/hapat e stafit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor (dhe afatet)</b>	<b>Dokumentimi nga stafi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
Nëse dyshon për një rast trafikimi bazuar në indikatorët e identifikimit fillestar, personeli i shërbimeve të kujdesit shëndetësor lidhet menjëherë me DRSH/DSHP dhe këta të fundit informojnë APAP-in.	Hapi i dokumentuar në A.5	Plotëson formularin e identifikimit fillestar dhe njofton Sekretariatit e AP.  Orienton punonjësën për referimin e rastit.	
Nëse situata e personit ka tregues trafikimi, pas trajtimit/normalizimit të gjendjes së tij/saj shëndetësore, punonjësi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor e vendos personin në një vend të veçantë dhe njofton pikën fokale për çështjet e trafikimit në Drejtorinë Rajonale Shëndetësore/Drejtorinë e Shëndetit Publik (psikolog apo punonjës social).	Hapi i dokumentuar në A.5		
Drejtoria Rajonale Shëndetësore/Drejtoria e Shëndetit Publik njofton APAP.	Hapi i dokumentuar në A.5	APAP është i disponueshëm për konsultimin e punonjësit	

<sup>40</sup> Pika 8 –të, neni 8-të i ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

Stafi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor shpjegon qëllimin e intervistës dhe zhvillon intervistën fillestare me personin që dëshiron të zhvillojë intervistë.	Hapi i dokumentuar në A.5 Shënimet/plotësimet në formatin e intervistës A.4		
Informon personin për gjykimin e tij/saj për statusin e tij dhe në bashkëpunim me të vendosin për ndihmën.	Vërtetim i statusit të identifikimit Z. 2		
Në varësi të vendimit: <i>Për personin që vendos të shkojë në shtëpi/familje:</i> Lëshon vërtetimin e statusit dhe informon personin se ku duhet të drejtohet më vonë në rast se kërkon ndihmë: <i>Për personin që ka nevojë të akomodohet në një qendër të sigurt:</i> komunikon me Drejtorinë Rajonale Shëndetësore/Drejtorinë e Shëndetit Publik dhe këta të fundit me APAP, kërkon paraqitjen e përfaqësuesve të ndihmës dhe lehtëson komunikimin me përfaqësuesit e ndihmës.	Vërtetim i statusit të identifikimit Z.2		
Punonjësi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor plotëson dhe dërgon pranë DRSH/DSHP dhe këta të fundit e përcjellin tek AP-ja me shkrim formularin A.5 Për rastet kur ka edhe dhunë në familje, punonjësi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor plotëson dhe dërgon edhe formatet e nevojshme të protokollit të dhunës në familje.	Hapi i dokumentuar në A.5	APAP e merr formularin dhe ia dërgon Sekretariatit të AP-së	Sekretariati i AP-së hedh të dhënat e rastit në data base



## STRUKTURAT E MBROJTJES SOCIALE NË BASHKI DHE NJMF/PUNONJËSIT E MBROJTJES SË FËMIJËVE

- **Treguesit për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit**

Fëmijët	Të rriturit
<ul style="list-style-type: none"> <li>• I mituri/e mitura është i/e sjellë nga një vend tjetër për të punuar/ nxjerrë më shumë para;</li> <li>• I mituri/e mitura ka lëvizur i/e paregjistruar asnjëherë në gjendje civile;</li> <li>• I mituri/e mitura largohet shpesh nga shtëpia;</li> <li>• I mituri/e mitura vetë, prindërit e tij/saj dhe motra vëllezër kanë qenë shpesh në kontakt me policinë dhe NJMF-në si pasojë e ekspozimit, pësimit të dhunës;</li> <li>• I mituri/e mitura ka një numër të kufizuar kontaktesh;</li> <li>• I mituri/e mitura kalon pjesën më të madhe të kohës në rrugë duke shitur, duke lypur, duke punuar;</li> <li>• Fëmijës i merren të ardhurat nga lypja, puna, veprimtaria nga më të rriturit;</li> <li>• I mituri/e mitura është i punësuar në mënyrë të paligjshme, punon në punë të rrezikshme;</li> <li>• I mituri/e mitura ka shenja dëmtimi që tregojnë se i mituri punon;</li> <li>• I mitur/e mitura i ka kontakte me individë apo grupe të dyshuara për aktivitete të paligjshme;</li> <li>• I mituri/e mitura shfaq frikë, është i/e tërhequr;</li> <li>• I mituri/e mitura ka mosbesim tek autoritetet;</li> <li>• I mituri/e mitura tregon histori të ngjashme dukshëm të mësuara;</li> <li>• Lejon të tjerët të flasin për të edhe pse mund të ketë moshën ose paraqitjen për t'u përgjigjur vetë;</li> <li>• I mituri/e mitura është i/e veshur keq, i/e paushqyer, i/e pakujdesur, pa gjumë të mjaftueshëm;</li> <li>• I mituri/e mitura deklaron se është keqpërdorur, abuzuar, kërcënuar, shfrytëzuar dhe është i kënaqur/ e kënaqur që ka rënë në kontakt me persona/autoritete që japin ndihmë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Personi është sjellë nga një vend tjetër për të punuar/ nxjerrë më shumë para;</li> <li>• Personi ka një numër të kufizuar kontaktesh;</li> <li>• Personi është i punësuar në mënyrë të paligjshme/punon në punë të rrezikshme;</li> <li>• Personi ka kontakte me individë apo grupe të dyshuara për aktivitete të paligjshme;</li> <li>• Shtrëngohen të punojnë në kushte të caktuara;</li> <li>• Vijnë nga një vend i njohur si vend origjine;</li> <li>• Nuk janë në gjendje të tregojnë dokumentat e identitetit;</li> <li>• Lejojnë të tjerët të flasin për ta;</li> <li>• Janë të paaftë të komunikojnë lirshëm me të tjerët;</li> <li>• Shfaqin ankth dhe frikë gjatë komunikimit;</li> <li>• Nuk kanë akses te shërbimi mjekësor;</li> <li>• Janë në punë të paligjshme;</li> <li>• Personi nuk kujdeset për higjenën e vet;</li> <li>• Personi ka shenja në trup (mavijosje p.sh.), që tregojnë dhunë fizike ose seksuale ndaj tij/saj;</li> <li>• Personit ia ka rregulluar punën, shkollën një person i cili/e cila ka marrëdhënie biznesi me punëdhënësin/punëdhënësen;</li> <li>• Personit nuk i është lejuar të zgjedhë strehimin.</li> </ul>

<p>dhe jep shenja se kërkon ndihmë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• I mituri/e mitura ka shenja në trup, (mavijosje p.sh.), që tregojnë dhunë fizike ose seksuale ndaj tij/saj;</li> <li>• I mituri/e mitura nuk ka një vendbanim të qëndrueshëm;</li> <li>• I mituri/e mitura fle në rrugë/është kapur duke vjedhur;</li> <li>• I mituri/e mitura frekuenton vende të njohura për aktivitete të paligjshme (shpërndarje droge, ushtrim prostitucioni, shkëmbim mallrash të vjedhura,etj);</li> <li>• I mituri/e mitura që lyp duket i/e lënë pas dore, është i/e kequshqyer/veshur në mënyrë të papërshtatshme për moshën apo kushtet atmosferike.</li> </ul>	
---	--

### HAPAT PËR TË MITURIT

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/ frontline (dhe afatet )</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/ frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e APAP dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
Nëse dyshon për një rast trafikimi bazuar në indikatorët e identifikimit fillestar, strukturat e mbrojtjes sociale në bashki/punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve njofton ASHMDF-në.	E mail  Hapi dokumentohet në A.5	Orienton punonjësin për referimin e rastit.	ASHMDF njofton D/KAP
Në rast se konstaton se i mituri/e mitura ka nevojë për ndihmë të menjëhershme mjekësore, punonjësi e kërkon asistencën e shërbimit shëndetësor.	Hapi dokumentohet në A.5		Qendra shëndetësore më e afërt trajton pa vonesë të miturin/ të miturën.
Siguron menjëherë përmbushjen e nevojave bazë të të miturit/miturës	Hapi dokumentohet në A.5		
Punonjësi PMF i vetëm ose punonjësi i shërbimeve sociale bashkë me PMF-në zhvillojnë intervistimin e fëmijës dhe bën vlerësimin e parë të nevojave të tij përfshirë vlerësimin e rrezikut nëse ka, nga familjarët e të miturit/ të miturës apo persona të tjerë.	Hapi dokumentohet në A.5 dhe shënimet në A.3		

<b>Afati/ kohëzgjatja:</b> sa është e nevojshme duke gjykuar mbi moshën dhe gjendjen e të miturit/ të miturës.			
Në rast se i mituri/ e mitura rezulton viktimë e mundshme e trafikimit sipas treguesve, dhe informacionit të intervistës, menjëherë pas intervistës, punonjësi kërkon thirrjen e takimit të GTN.	Formati Z.3		
NJMF/PMF kryejnë dhe ndërmarrin veprimet konkrete për menaxhimin e rastit të fëmijëve, me qëllim garantimin e mbrojtjes apo aksesin e të drejtave të fëmijës	Formatet Z.4, Z.5, Z.6		

#### HAPAT PËR TË RRITURIT

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/ frontline (dhe afatet)</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/ frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e AP dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
Nëse dyshon për një rast trafikimi bazuar në indikatorët e identifikimit fillestar, strukturat e mbrojtjes sociale në bashki marrin masa për trajtimin e rastit dhe njoftojnë Sekretariatit e AP.	Hapi dokumentohet në Formatin A.5	Sekretariati i AP administron të dhënat dhe organizon takimin e AP kur është e nevojshme.	
Në rast se konstaton se i rrituri/e rritura ka nevojë për ndihmë të menjëhershme mjekësore, strukturat e mbrojtjes sociale në bashki njoftojnë menjëherë qendrën më të afërt shëndetësore.	Hapi dokumentohet në Formatin A.5		Qendra shëndetësore më e afërt trajton pa vonesë të rriturin/ të rriturën
Në rast personi nuk pranon përgjithësisht të komunikojë me punonjësën e strukturës së bashkisë, ose në rast se persona të tjerë pengojnë punonjësën në këto dhe hapat e mëtejshme të procedurës, punonjësi njofton drejtuesin e shërbimeve sociale i	Hapi dokumentohet në Formatin A.1		

cili njofton menjëherë policinë.			
Punonjësi zhvillon intervistën fillestare me personin që dëshiron dhe arrin në konkluzione lidhur me statusin e tij/saj në lidhje me trafikimin dhe informon drejtorin e shërbimeve sociale të bashkisë.	Hapi dokumentohet në Formatin A.5 dhe shënimet në A.4		
Punonjësi i shërbimeve sociale harton menjëherë njoftimin për Mbrojtjen /identifikimin dhe ia dërgon atë në rrugë elektronike AP.	Hapi dokumentohet në Formatin A.5	Punonjësi përcjell njoftimin tek D/KAP sekretariati i AP-së	Sekretariati i AP-së hedh të dhënat në sistem

### SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

- **Treguesit për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit**

<b>Fëmijët</b>	<b>Të rriturit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• I mituri/e mitura është i/e sjellë nga një vend tjetër për të punuar/ nxjerrë më shumë para;</li> <li>• I mituri/e mitura ka lëvizur i/e paregjistruar asnjëherë në gjendjen civile;</li> <li>• I mituri/e mitura largohet shpesh nga shtëpia;</li> <li>• I mituri/e mitura ka një numër të kufizuar kontaktesh;</li> <li>• I mituri /e mitura kalon pjesën më të madhe të kohës në rrugë duke shitur, duke lypur, duke punuar;</li> <li>• Fëmijës i merren të ardhurat nga lypja, puna, veprimtaria nga më të rriturit;</li> <li>• I mituri/e mitura është i punësuar në mënyrë të paligjshme, punon në punë të rrezikshme;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Personi është sjellë nga një vend tjetër për të punuar/ nxjerrë më shumë para;</li> <li>• Personi ka një numër të kufizuar kontaktesh;</li> <li>• Personi është i punësuar në mënyrë të paligjshme/punon në punë të rrezikshme;</li> <li>• Personi ka kontakte me individë apo grupe të dyshuara për aktivitete të paligjshme;</li> <li>• Shtrëngohen të punojnë në kushte të caktuara;</li> <li>• Vijnë nga një vend i njohur si vend origjine;</li> <li>• Nuk janë në gjendje të tregojnë dokumentet e identitetit;</li> <li>• Lejojnë të tjerët të flasnin për ta;</li> <li>• Janë të paafët të komunikojnë lirshëm me të tjerët;</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• I mituri/e mitura ka shenja dëmtimi që tregojnë se i mituri punon;</li> <li>• I mituri/e mitura ka kontakte me individë apo grupe të dyshuara për aktivitete të paligjshme;</li> <li>• I mituri/e mitura shfaq frikë, është i/e tërhequr;</li> <li>• I mituri/e mitura ka mosbesim tek autoritetet;</li> <li>• I mituri/e mitura tregon histori të ngjashme dukshëm të mësuara;</li> <li>• Lejon të tjerët të flasin për të edhe pse mund ketë moshën ose paraqitjen për t'u përgjigjur vetë;</li> <li>• I mituri/e mitura është i/e veshur keq, i/e paushqyer, i/e pakujdesur, pa gjumë të mjaftueshëm;</li> <li>• I mituri/ e mitura deklaron se është keqpërdorur, abuzuar, kërcënuar, shfrytëzuar dhe është i kënaqur/ e kënaqur që ka rënë në kontakt me persona/autoritete që japin ndihmë dhe jep shenja se kërkon ndihmë;</li> <li>• I mituri/e mitura ka shenja në trup (mavijosje p.sh.), që tregojnë dhunë fizike ose seksuale ndaj tij/saj;</li> <li>• I mituri/e mitura shet ose punon, nuk ka kontroll mbi jetën e tij; lëvizja, strehimi, përdorimi i të ardhurave, udhëhiqen dhe kontrollohen nga persona të tjerë;</li> <li>• I mituri/e mitura nuk ka kontakte me familjen dhe nuk ka person me lidhje gjaku që kujdeset për të;</li> <li>• I mituri/e mitura nuk ka një vendbanim të qëndrueshëm;</li> <li>• I mituri/e mitura fle në rrugë;</li> <li>• I mituri/e mitura frekuenton vende të njohura për aktivitete të paligjshme (shpërndarje droge, ushtrim prostitucioni, shkëmbim mallrash të vjedhura, etj);</li> <li>• I mituri/e mitura është kapur duke vjedhur.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shfaqin ankth dhe frikë gjatë komunikimit;</li> <li>• Nuk kanë akses te shërbimi mjekësor;</li> <li>• Janë në punë të paligjshme;</li> <li>• Personi nuk kujdeset për higjenën e vet;</li> <li>• Personi ka shenja në trup (mavijosje p.sh.), që tregojnë dhunë fizike ose seksuale ndaj tij/saj;</li> <li>• Transporti i personit, strehimi, punësimi, janë rregulluar nga persona që njihen apo për të cilët ka informacion se janë trafikantë apo shfrytëzues;</li> <li>• Personit ia ka rregulluar punën, shkollën një person i cili/e cila ka marrëdhënie biznesi me punëdhënësin/punëdhënësen;</li> <li>• Personit nuk i është lejuar të zgjedhë strehimin.</li> </ul>
--	---

### HAPAT PËR TË MITURIT

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/ frontline (dhe afatet)</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
---	--	--	---

	<b>frontline</b>		
Nëse dyshon për një rast trafikimi bazuar në indikatorët e identifikimit fillestar, punonjësi social merr masa për trajtimin e rastit dhe njofton menjëherë APAP dhe NJMF.	Hapi dokumentohet në Formatin A.5	Njofton sekretariatit e AP dhe orienton punonjësin për trajtimin e rastit.	
Siguron menjëherë përmbushjen e nevojave bazë të të miturit/miturës.	Hapi dokumentohet në Formatin A.5		
Në rast se fëmija ose prindi, kujdestari i fëmijës nuk pranojnë të shkojnë në qendërën shëndetësore, si dhe nuk pranojnë përgjithësisht të komunikojnë me punonjësin e shërbimit social shtetëror, ose në rast se, persona të tjerë pengojnë punonjësin në këto dhe hapat e mëtejshme të procedurës, punonjësi njofton drejtorin rajonal të shërbimeve sociale, i cili njofton menjëherë policinë për ta detyruar fëmijën të marrë trajtimin e gjykuar të nevojshëm.	Hapi dokumentohet në Formatin A.1		
Nëse nuk është i/e specializuar për fëmijët, punonjësi i kërkon drejtorit të kërkojë prej bashkisë caktimin e një PMF-je për intervistimin e fëmijës.			
Punonjësi i vetëm ose së bashku me PMF-në zhvillojnë intervistimin e fëmijës. Punonjësi lehtëson takimin për shqyrtimin e interesit më të lartë të fëmijës të kryesuar nga PMF-ja në të cilin marrin pjesë kujdestari ose prindi i fëmijës, punonjës të policisë.	Hapi dokumentohet në A.5		
Në rast se i mituri/ e mitura rezulton viktimë e mundshme e trafikimit sipas treguesve, dhe informacionit të intervistës, menjëherë pas intervistës, NJMF/PMF kërkon thirrjen e takimit të GTN.	Formati Z.3		

Punonjësi i shërbimit social shtetëror ndërmerr hapa sipas vendimit të marrë në takim, duke mbështetur PMF dhe lehtësuar vendosjen e fëmijës në një qendër rezidenciale, qëndrimin në familje etj.	Hapi dokumentohet në Formatin A.5		
Punonjësi i shërbimeve sociale harton menjëherë njoftimin për Mbrojtjen /identifikimin dhe ia dërgon atë në rrugë elektronike APAP.	Hapi dokumentohet në Formatin A.5	APAP e përcjell tek sekretariati i AP-së	Sekretariati i AP-së hedh të dhënat në sistem

### HAPAT PËR TË RRITURIT

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/frontline (dhe afatet )</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
Punonjësi i shërbimit social shtetëror, nëse dyshon për një rast trafikimi bazuar në indikatorët e identifikimit fillestar, merr msa për trajtimin e rastit.	Hapi dokumentohet në Formatin A.5		
Në rast se konstaton se personi ka nevojë për ndihmë të menjëhershme mjekësore, punonjësi e shoqëron personin në qendrën shëndetësore ose thërret urgjencën mjekësore.	Hapi dokumentohet në Formatin A.5		
Në rast se personi nuk pranon të marrë ndihmë ose nuk pranon përgjithësisht të komunikojnë me punonjësin e shërbimit social shtetëror, ose në rast se persona të tjerë pengojnë punonjësin në këto dhe hapat e mëtejshme të procedurës, punonjësi: -E informon personin ku duhet të drejtohet për ndihmë -njofton drejtorin rajonal të shërbimeve sociale i cili njofton menjëherë gojarisht policinë për identifikimin.	Hapi dokumentohet në Formatin A.1		

Në rast se personi pranon, punonjësi zhvillon me të intervistën fillestare dhe bën vlerësimin e parë të nevojave.	Hapi dokumentohet në Formatin A.5		
Punonjësi i shërbimit social shtetëror e informon personin për mundësitë e ndihmës dhe ndërmer hapa sipas vendimit të marrë: Në rast të nevojës dhe vendimit për akomodim në një strehëz, njofton APAP dhe kërkon dërgimin e punonjësve të strehëzës dhe lehtëson takimin me ta. Në rast të nevojës dhe vendimit për qëndrim në familje apo në mënyrë të pavarur informon për mundësitë dhe mënyrën e kontaktit me ndihmën.	Hapi dokumentohet në Formatin Z.4 deklarim i vendimit të informuar për ndihmë, Z.5 Deklarim i marrjes në kujdes nga institucioni	APAP komunikon me D/KAP dhe dërgojnë një përfaqësues të ndihmës	
Punonjësi i shërbimeve sociale harton menjëherë njoftimin për Mbrojtjen /identifikimin dhe ia dërgon atë në rrugë elektronike APAP.	Njoftimi në Formatin A.5	APAP e përcjell tek sekretariati i AP-së	Sekretariati i AP-së hedh të dhënat në sistem

**NJËSITË E PËRBASHKËTA TË KOORDINUARA (NJËSITË LËVIZËSE, SKUADRA TERRENI, TASK FORCA);  
INSTITUCIONET E KUJDESIT REZIDENCIAL DHE DITOR, INSTITUCIONET KOMBETARE DHE  
NDËRKOMBËTARE JO ANËTARE TË MKR-SË ME/PA PROGRAME PËR VIKTIMAT/VIKTIMAT E MUNDSHME TË  
TRAFIKIMIT<sup>41</sup>**

**• Treguesit për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit**

<b>Fëmijët</b>	<b>Të rriturit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• I mituri/e mitura është i/e sjellë nga një vend tjetër për të punuar/nxjerrë më shumë para;</li> <li>• I mituri/e mitura ka lëvizur i/e parregjistruar asnjëherë në gjendje civile;</li> <li>• I mituri/e mitura largohet shpesh nga shtëpia;</li> <li>• I mituri/e mitura vetë, prindërit e tij/saj dhe motra vëllezër kanë qenë shpesh në kontakt me policinë dhe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Personi është sjellë nga një vend tjetër për të punuar/nxjerrë më shumë para;</li> <li>• Personi ka një numër të kufizuar kontaktesh;</li> <li>• Personi është i punësuar në mënyrë të paligjshme/punon në punë të rrezikshme;</li> <li>• Personi ka kontakte me individë apo grupe të dyshuara për aktivitete të paligjshme;</li> </ul>

<sup>41</sup> Punonjësi i njësisë së koordinuar, institucionit rezidencial, ditor, kombëtar dhe ndërkombëtar në vijim do të referohen si “Punonjësi”



NJMF-në si pasojë e ekspozimit, pësimit të dhunës ;

- I mituri/e mitura ka një numër të kufizuar kontaktesh;
- I mituri/e mitura kalon pjesën më të madhe të kohës në rrugë duke shitur, duke lypur, duke punuar;
- Fëmijës i merren të ardhurat nga lypja, puna, veprimtaria nga më të rriturit;
- I mituri/e mitura është i punësuar në mënyrë të paligjshme, punon në punë të rrezikshme;
- I mituri/e mitura ka shenja dëmtimi që tregojnë se i mituri/e mitura punon;
- I mituri/e mitura ka kontakte me individë apo grupe të dyshuara për aktivitete të paligjshme;
- I mituri/e mitura shfaq frikë, është i/e tërhequr;
- I mituri/e mitura ka mosbesim tek autoritetet;
- I mituri/e mitura tregon histori të ngjashme dukshëm të mësuara;
- Lejon të tjerët të flasin për të edhe pse mund ketë moshën ose paraqitjen për t'u përgjigjur vetë;
- I mituri/e mitura është i/e veshur keq, i/e paushqyer , i/e pakujdesur, pa gjumë të mjaftueshëm;
- I mituri/e mitura deklaron se është keqpërdorur, abuzuar, kërcënuar, shfrytëzuar dhe është i kënaqur/e kënaqur që ka rënë në kontakt me persona/autoritete që japin ndihmë dhe jep shenja se kërkon ndihmë;
- I mituri/e mitura ka shenja në trup, (mavijosje p.sh.), që tregojnë dhunë fizike ose seksuale ndaj tij/saj;
- I mituri/e mitura nuk ka një vendbanim të qëndrueshëm.
- I mituri/e mitura fle në rrugë;
- I mituri/e mitura frekuenton vende të njohura për aktivitete të paligjshme (shpërndarje droge, ushtrim prostitucioni, shkëmbim mallrash të vjedhura,etj);
- I mituri/e mitura është kapur duke vjedhur.

- Shtrëngohen të punojnë në kushte të caktuara;
- Vijnë nga një vend i njohur si vend origjine;
- Nuk janë në gjendje të tregojnë dokumentat e identitetit;
- Lejojnë të tjerët të flasin për ta;
- Janë të paaftë të komunikojnë lirshëm me të tjerët;
- Shfaqin ankth dhe frikë gjatë komunikimit;
- Nuk kanë akses te shërbimi mjekësor;
- Janë në punë të paligjshme;
- Personi nuk kujdeset për higjienën e vet;
- Personi ka shenja në trup (mavijosje p.sh.), që tregojnë dhunë fizike ose seksuale ndaj tij/saj;
- Personit ia ka rregulluar punën, shkollën një person i cili/e cila ka marrëdhënie biznesi me punëdhënësin/punëdhënësen;
- Personit nuk i është lejuar të zgjedhë strehimin.

## HAPAT PËR TË MITURIT

Detyrat/hapat e punonjësve	Dokumentimi nga punonjësi	Detyrat/hapat e Sekretariatit të AP-së dhe afatet
Nëse punonjësi, dyshon për një rast të mundshëm trafikimi, bazuar në indikatorët e identifikimit fillestar, njofton menjëherë sekretariatit e AP-së. Gjithashtu, kontakton NJMF-në e zonës së bashku me drejtuesin e institucionit.	Email në adresën: <a href="mailto:autoriteti.pergjegjes@mb.gov.al">autoriteti.pergjegjes@mb.gov.al</a>	Orienton punonjësin lidhur me referimin e rastit.
Siguron menjëherë përmbushjen e nevojave bazë të të miturit. Në rast se, i mituri ka nevojë për asistencë shëndetësore njoftohet menjëherë shërbimi shëndetësor.	Hapi dokumentohet në Formatin A.5	Qendra shëndetësore më e afërt trajton pa vonesë të miturin/ të miturën
Pas adresimit të nevojave bazë, punonjësi zhvillon intervistën me të miturin/miturën me qasjen për vlerësimin e rrezikut nëse ka, nga familjarët e tij apo persona të tjerë; <b>Afati/ kohëzgjatja:</b> sa është e nevojshme, duke gjykuar mbi moshën dhe gjendjen e të miturit/ të miturës.	Hapi dokumentohet në Formularin A.2	
Nëse ka mundësi për të kontaktuar me prindin apo kujdestarin ligjor, e bën vetë menjëherë ose nëpërmjet strukturave mbështetëse që i referon/orienton Sekretariati i AP-së.	Informon me e-mail Sekretariatit e AP-së në lidhje me punën e kryer.	Hedh të dhënat në databazën e VT.
Anëtari/anëtarët e njësisë marrin pjesë në mbledhjen e organizuar nga PMF-ja për vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe kryen veprime sipas vendimit të marrë.	Formulari Z3	Nëse është e nevojshme organizon takimin e AP-së për rastin.
Anëtari i njësisë së lëvizshme përgatit dhe kryesuesi i njësisë rishikon dhe dërgon tek AP-ja njoftimin për identifikimin.	Hapi dokumentohet në Formatin A.5	

## HAPAT PËR TË RRITURIT

Detyrat/hapat e punonjësve	Dokumentimi nga punonjësi	Detyrat/hapat e Sekretariatit të AP-së dhe afatet	Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë AP-në dhe afatet)
<p>Nëse punonjësi ka dyshime, bazuar në indikatorët e identifikimit fillestar, për një rast të mundshëm trafikimi njofton menjëherë sekretariatit e AP-së.</p> <p>Nëse njësia e koordinuar nuk ka në përbërje të vet punonjës të specializuar/profesionistë për intervistimin e të rriturve viktime të trafikimit, njësia i kërkon AP-së edhe një person të përshtatshëm për intervistim.</p>	<p>Email në adresën: <a href="mailto:autoriteti.pergjegjes@mb.gov.al">autoriteti.pergjegjes@mb.gov.al</a></p>	<p>Orienton punonjësën në lidhje me hapat që duhen ndërmarrë.</p>	
<p>Nëse personi nuk dëshiron apo nuk mundet, dhe nëse Njësia nuk ka në përbërje të vet punonjës të policisë, atëherë anëtari i Njesisë njofton menjëherë gojarisht policinë ose raporton tek 116006 ose Aplikacioni “Raporto! Shpëto!”.</p>	<p>Formulari A.1</p>		
<p>Anëtari i njësisë së bashku me ekspertin e dërguar nga AP-ja zhvillojnë intervistën.</p>	<p>Formulari A4 intervista fillestare për të rritur</p>		
<p>Punonjësi e informon personin për mundësitë e ndihmës dhe ndërmarrin hapa sipas vendimit të marrë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Në rast të nevojës dhe vendimit për akomodim në një strehëz, njoftohet AP dhe kërkohet dërgimi i punonjësve të strehëzës, dhe lehtësohet takimi me ta;</li> <li>-Në rast të nevojës dhe vendimit për qëndrim në familje apo në mënyrë të pavarur personi informohet për mundësitë dhe mënyrën e kontaktit me ndihmën.</li> </ul>			

<p>Punonjësi konsultohet edhe me Sekretariatit e AP-së dhe referon rastin për ndihmë sipas vullnetit të viktimës së mundshme të trafikimit të personave.</p>	<p>Telefonohet Sekretariati i AP-së E-mail në lidhje me hapat që u morën për rastin.</p>	<p>Me marrjen e informacionit, nëse është e nevojshme organizon takimin e AP-së. Hedh të dhënat në bazën e të dhënave</p>	
--	--	---	--

**PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (PDRSH)**

**Treguesit për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit**

<b>Fëmijët</b>	<b>Të rriturit</b>
----------------	--------------------

<ul style="list-style-type: none"> <li>• I mituri/e mitura është sjellë në vendin e konstatimit/ qytetin apo krahinën nga një person i rritur apo më i rritur me të cilin nuk ka lidhje familjare;</li> <li>• I mituri/e mitura i paregjistruar, qëndron me persona të rritur me të cilët nuk ka lidhje familjare;</li> <li>• I mituri/e mitura është në shoqërinë e personave që shfrytëzojnë apo trafikojnë të miturit;</li> <li>• I mituri/e mitura nuk ka të njëjtën moshë me dokumentin identifikues;</li> <li>• I mituri/e mitura nuk ka një vendbanim të qëndrueshëm;</li> <li>• I mituri/e mitura fle në rrugë;</li> <li>• I mituri/e mitura frekuenton vende të njohura për aktivitete të paligjshme (shpërndarje droge, ushtrim prostitucioni, shkëmbim mallrash të vjedhura,etj);</li> <li>• I mituri/e mitura është kapur duke vjedhur;</li> <li>• I mituri/e mitura që lyp duket i/e lënë pas dore, është i/e keq-ushqyer, veshur në mënyrë të papërshtatshme për moshën apo kushtet atmosferike;</li> <li>• Ka të dhëna apo informacion që i mituri/e mitura është parë në vende që njihen se përdoren për shfrytëzim seksual të fëmijëve, për lypje, punë të detyruar, apo vende të tjera të papërshtatshme për moshën;</li> <li>• I mituri/e mitura ka lënë shtëpinë/vendin e kujdesit me rroba që janë të pazakonshme për këtë të mitur (të papërshtatshme për moshën, i ka marre borxh prej më të rriturve).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Personi është sjellë nga një vend tjetër për të punuar/ nxjerrë më shumë para;</li> <li>• Personi ka një numër të kufizuar kontaktesh;</li> <li>• Personi është i punësuar në mënyrë të paligjshme/punon në punë të rrezikshme;</li> <li>• Personi ka kontakte me individë apo grupe të dyshuara për aktivitete të paligjshme;</li> <li>• Shtrëngohen të punojnë në kushte të caktuara;</li> <li>• Vijnë nga një vend i njohur si vend origjine;</li> <li>• Nuk janë në gjendje të tregojnë dokumentat e identitetit;</li> <li>• Lejojnë të tjerët të flasin për ta;</li> <li>• Janë të paaftë të komunikojnë lirshëm me të tjerët;</li> <li>• Shfaqin ankth dhe frikë gjatë komunikimit;</li> <li>• Nuk kanë akses te shërbimi mjekësor;</li> <li>• Janë në punë të paligjshme;</li> <li>• Personi nuk kujdeset për higjenën e vet;</li> <li>• Personi ka shenja në trup (mavijosje p.sh.), që tregojnë dhunë fizike ose seksuale ndaj tij/saj;</li> <li>• Personit ia ka rregulluar punën, shkollën një person i cili/e cila ka marrëdhënie biznesi me punëdhënësin/ punëdhënësen;</li> <li>• Personit nuk i është lejuar të zgjedhë strehimin;</li> <li>• Kushtet në të cilat punon personi, kanë qenë të dëmshme për shëndetin dhe jetën e personit;</li> <li>• Personi fshihet nga autoritetet për shkak të statusit të parregullt të punës së tij/saj;</li> <li>• Personi nuk ka akses në kujdesin shëndetësor;</li> <li>• Personi ka/ka pasur kontakte sociale të kufizuara.</li> </ul>
---	---

### HAPAT PËR TË MITURIT

<b>Detyrat/hapat e punonjësit të përfaqësisë diplomatike</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësi i përfaqësisë diplomatike</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>
Nëse punonjësi i PDRSH konstaton nga dokumentacioni apo kontakti me një shtetas shqiptar të mitur se mund të jetë para një rasti viktime të mundshme të trafikimit, menjëherë njofton APAP-in.	1. Email i menjëhershëm në adresën zyrtare të APAP 2. Shkresë zyrtare	Orienton punonjësën në lidhje me hapat që duhet të ndjekë më tej.
Punonjësi i PDRSH, sipas orientimit të APAP, kontakton me organizatat që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit në vendin ku ndodhet përfaqësia diplomatike nëse rasti ka nevojë për ndihmë deri në kthimin vullnetar të asistuar.	1. Telefon 2. E-mail drejtuar organizatave 3. E-mail APAP në lidhje me hapat e ndërmarrë	Kontakton dhe informon Sekretariatën e AP-së në lidhje me informacionin e marrë.
Punonjësi i PDRSH e vendos të miturin/ të miturën dhe kujdestarin e tij/saj në kontakt me ofruesit e shërbimeve në vendin e destinacionit.		Sekretariati i AP kontakton Autoritetin e Përgjegjës të zbatimit të Marrëveshjes/Memorandumit/Protokollit aty ku ka në lidhje me identifikimin e kryer.
Punonjësi i PDRSH negocion me autoritetet në vendin e destinacionit dhe të origjinës për të kontaktuar me prindërit/kujdestari ligjor të të miturit.		Sekretariati i AP koordinon vlerësimin e riskut me anëtarët e AP.
Punonjësi i PDRSH koordinon kthimin vullnetar të asistuar të të miturit bazuar në vlerësimin e riskut dhe të interesit më të lartë të fëmijës.		APAP njofton Sekretariatën e AP në lidhje me kthimin dhe koordinojnë pritjen e të miturit.

### HAPAT PËR TË RRITURIT

<b>Detyrat/hapat e punonjësit të përfaqësisë diplomatike</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësi i përfaqësisë diplomatike</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>
Nëse punonjësi i PDRSH konstaton nga dokumentacioni apo kontakti me një shtetas shqiptar të rritur se mund të jetë para një viktime të mundshme e trafikimit, menjëherë njofton APAP-in.	1. Email i menjëhershëm në adresën zyrtare të APAP 2. Shkresë zyrtare	Orienton punonjësën në lidhje me hapat që duhet të ndjekë më tej.
Punonjësi i PDRSH, sipas orientimit të APAP, kontakton me organizatat që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit në vendin ku ndodhet përfaqësia diplomatike nëse rasti ka nevojë për ndihmë deri në	1. Telefon 2. E-mail drejtuar organizatave 3. E-mail APAP në lidhje	Kontakton dhe informon Sekretariatën e AP-së në lidhje me informacionin e marrë. Sekretariati i AP kontakton Autoritetin

kthimin vullnetar të asistuar	me hapat e ndërmarrë	Përgjegjës të zbatimit të Marrëveshjes/Memorandumit/Protokollit aty ku ka në lidhje me identifikimin e kryer.
Punonjësi i PDRSH koordinon kthimin vullnetar të asistuar të të rriturit		APAP njofton Sekretariatit e AP-së në lidhje me kthimin dhe koordinojnë pritjen e të miturit.

## Identifikimi formal

### *Përkufizimi dhe Përgjegjësitë*

- **Identifikimi formal**, është identifikimi i një personi si viktimë trafikimi i kryer vetëm nga Grupi/Struktura Përgjegjëse për Identifikim Formal (G/SPIF) në bazë të formatit të intervistës formale të përfshirë në këtë dokument, e cila kryhet me vullnetin e vetë viktimës dhe kur ajo është e gatshme për ta kryer atë. **Identifikimi formal përfshin minimalisht:** 1. ndërhyrjen e menjëhershme të Sektorit për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm për kryerjen e Intervistës formale kur njoftohet nga agjensia referuese apo kur vetë viktimja e mundshme e trafikimit shpreh vullnetin pranë strukturave të policisë së shtetit për të kryer intervistën formale 2. përcaktimin nëse personi është i/e trafikuar, nëpërmjet mbledhjes dhe analizës së informacionit të dhënë nga vetë personi 3. vlerësimin në mënyrë të thelluar të nevojave të personit viktimë e trafikimit për ndihmë dhe mbrojtje; 4. dhënien e udhëzimeve dhe sigurimin e qasjes së personit të trafikuar tek ndihma e përshtatshme dhe e sigurt 5. grumbullimin e informacionit dhe nisjen e hetimeve për penalizimin e trafikantëve 6. intervista formale/vërtetimi i statusit të personit si i/e trafikuar kryhet veçmas në kohë nga kallëzimi (*edhe nëse personi dëshiron të bëjë kallëzim, në asnjë rast, intervista formale nuk ndërpritet për të marrë kallëzimin, por caktohet një kohë tjetër*).
- **Agjencia/institucioni përgjegjës për identifikimin formal është Grupi/ Struktura Përgjegjëse për Identifikimin Formal në kufijtë dhe territorin e RSH-së (G/SPIF):** i ngritur (ad hoc) që kryen intervistimin formal të personave që identifikohen si viktimja të mundshme të trafikimit, e përbërë nga një punonjës i policisë së shtetit i seksionit të luftës kundër trafikëve të paligjshme (SLKTP) dhe punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve/NJMF në bashki/njësi administrative për çdo rast të të miturve dhe një punonjës social shtetëror i zyrës rajonale të shërbimit social shtetëror (ZRSSSH) për të rriturit.

### *Mjetet e identifikimit formal dhe kushtet e përdorimit të tyre*

- Mjeti i identifikimit formal është intervista formale dhe konsultimi i AP-së. Nëpërmjet intervistës përcaktohet përfundimisht statusi i personit në lidhje me trafikimin, bëhet vlerësimi i thelluar i nevojave të personit për ndihmë dhe mbrojtje, jepen udhëzime dhe sigurohet qasja e personit të trafikuar tek ndihma e përshtatshme afatgjatë dhe e sigurt dhe grumbullohet

informacion për nisjen e hetimeve për penalizimin e trafikantëve. Intervista fillon me pjesën e vlerësimit të nevojave dhe drejtohet nga PMF-ja ose punonjës të shërbimit social shtetëror dhe vijon me pjesën e mbledhjes së informacionit lidhur me procesin e trafikimit dhe drejtohet nga punonjësi i policisë. NJMF/PMF kryejnë dhe ndërmarrin veprimet konkrete për menaxhimin e rastit të fëmijëve, me qëllim garantimin e mbrojtjes apo aksesin e të drejtave të fëmijës.

- Intervista formale/vërtetimi i statusit të personit si i/e trafikuar kryhet përpara kallëzimit, duke vlerësuar njëkohësisht edhe kohën më të përshtatshme të mëvonshme për deklarime apo kallëzime në organet e policisë dhe prokurorisë.
- Kushtet e intervistimit formal janë: është bërë kërkesë për zhvillimin e intervistës nga një institucion; personi ka një vërtetim të identifikimit fillestar; personi që është i huaj intervistohet vetëm nga përkthyes që kanë nënshkruar deklaratën e konfidencialitetit; personi është i/e shoqëruar nga një punonjës që e njeh mirë dhe tek i cili/e cila ka besim; intervistimi kryhet në një ambient që është i sigurt dhe i mbrojtur për personin që do të intervistohet dhe personat e tjerë që do të marrin pjesë në intervistim, larg personave që dyshohet se mund të jenë përfshirë në trafikim; të gjithë personat që marrin pjesë në intervistim e kanë të qartë rolin e tyre; personi që do të intervistohet nuk lihet të presë gjatë; personi nuk intervistohet në grup me persona të tjerë; personi nuk intervistohet nëse ka shenja se nuk ndihet mirë fizikisht apo emocionalisht; personit i jepet ndihmë e menjëhershme mjekësore dhe psikologjike nëse konstatohet se ka nevojë për këtë; kurdoherë që është e mundur personi intervistohet nga persona të së njëjtës gjini; dera e dhomës/ ambientit ku do të bëhet intervistimi mbahet e mbyllur gjatë gjithë kohës së intervistimit për të ruajtur konfidencialitetin dhe të mos ndërpritet intervistimi dhe personit i shpjegohen qartë arsyet për këtë; intervistimi kryhet në mjedise/dhoma që janë mjaft larg nga dhoma ku mbahen persona të ndaluar; personit që intervistohet i shpjegohet qartë se ka të drejtë ta ndërpresë intervistën në momentin që ndjehet nën presion apo jo në vullnetin e vet të plotë e të lirë për t'u përgjigjur. Në asnjë mënyrë intervista nuk ndërpritet për shkak të detyrave të tjera që dalin gjatë kohës së intervistës; telefonat celularë mbahen të heshtur nga të gjithë personat e pranishëm gjatë intervistës; personit që intervistohet dhe kujdestarit apo prindit në rastin e të miturit i shpjegohet çdo shënim që mbahet gjatë kohës së intervistimit, qëllimet për të cilat mbahen shënimet dhe i jepet informacion i kuptueshëm se si do ruhet e me kë do ndahet ky informacion; Personit që intervistohet dhe kujdestarit apo prindit në rastin e të miturit i shpjegohet qartë procedura dhe qëllimi i intervistimit, kohëzgjatja e intervistës dhe i sigurohet që është i lirë/ e lirë, ta ndërpresë intervistimin në çdo kohë; menaxheri i rastit apo prindit/kujdestarit ligjor (nëse ata nuk dyshohet të jenë të përfshirë në trafikimin e të miturit mund të jenë prezent gjatë intervistimit nëse këtë e kërkon fëmija apo personi i rritur), por nuk mund të drejtojnë intervistën.
- Rregullat e komunikimit për intervistuesit dhe për të intervistuarin janë të njëjta me ato të identifikimit fillestar.

#### *Dokumentimi*

- Formatet standarde që duhet të përdoren për të lehtësuar komunikimin midis institucioneve dhe agjencive, si dhe të dokumentojnë se institucionet përgjegjëse veprojnë në përputhje me këto procedura për identifikimin formal janë: B.1 “Deklaratë e vullnetit për identifikim formal”; B.2 “Kërkesë për identifikim formal”; B.3 “Strukturë e intervistës formale për fëmijë”; B.4 “Strukturë e intervistës formale për të rritur”; B.5 “Njoftim për zbatimin e detyrimit të identifikimit formal”.



*Koha*

- Të gjitha veprimet për identifikimin formal duhet të zhvillohen në kohën më të shpejtë të mundshme. Në secilin prej hapave për sektorë të ndryshëm jepet koha maksimale e zhvillimit të hapit, megjithatë koha maksimale për hapat kryesore për të gjitha agjencitë pa përjashtim është :

<b>Hapi/veprimi</b>	<b>Koha e fillimit dhe kohëzgjatja maksimale</b>	<b>Mënyra e matjes (fillimi, mbarimi)</b>
<i>Nxitja/çuarja në intervistë formale</i>		
Nxitja e personit viktimë e mundshme e trafikimit për zhvillimin e intervistës formale	Menjëherë dhe vazhdimisht	Sapo bihet në kontakt me viktimën e mundshme të trafikimit
Dërgimi i kërkesës për identifikim formal	Brenda ditës, sapo personi shpreh dëshirën	
Caktimi i ditës dhe arranzhimet nga SKLPT për intervistë formale	Brenda dy ditësh nga marrja e kërkesës	
Intervista formale e fëmijës	Në varësi të moshës së fëmijës, por maksimumi 60 minuta	
Intervista formale e të rriturit	Në varësi të të kuptuarit, por maksimumi 90 minuta	
Mbledhja për shqyrtimin dhe vendimin në interesin me të lartë të fëmijës	Maksimumi 1 orë	Një orë nga intervista, përfshirë dokumentimin
Dërgimi i njoftimit me shkrim/elektronikisht tek AP/APAP	Brenda ditës së intervistimit	
Konsultimi		

*Hapat për sjelljen e personit “fëmijë” ose të “rritur” në intervistë formale (referimin, nxitjen apo rekomandimin e personit për intervistë formale)*

<b>Detyrat/hapat e punonjësit</b>	<b>Dokumentimin nga ana e punonjësve</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Dokumentimi nga Anëtari Respektiv i AP-së</b>
Punonjësi i agjencisë që ka rënë/është në kontakt me viktimën e mundshme të trafikimit fëmijë ose të rritur informon personin dhe	Deklaratë e vullnetit për		

kujdestarin e tij/saj mbi qëllimet e intervistës formale dhe mbështetjen që mund të japë agjencia për këtë, dokumenton vendimin lidhur me identifikimin formal.	identifikim formal B1		
Punonjësi i agjencisë përgatit kërkesën për personin që ka rënë dakord për intervistë formale.	Formulari B.2		
Drejtuesi i agjencisë e rishikon dhe e nis kërkesën elektronikisht në AP.	Formulari B.2	APAP e dërgon kërkesën tek D/KAP dhe sekretariati i AP-së	Sekretariati ia nis kërkesën strukturave vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm më afër personit që dëshiron të identifikohet. Formalisht Strukturat vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm komunikojnë me strukturat sociale në bashki (kur është fjala për fëmijë) ose me shërbimin social shtetëror dhe i kthejnë përgjigje sekretaritit të APsë dhe agjencisë lidhur me organizimet e bëra
Me marrjen e përgjigjes nga struktura vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm, drejtuesi i agjencisë bën organizimet për të siguruar pjesëmarrjen në intervistë formale të personit viktimë e mundshme e trafikimit që është akomoduar në stehëzën apo bën pjesë në programin e agjencisë dhe të punonjësit të vet.	Hapi dokumentohet në B.5		
Drejtuesi i agjencisë bën organizimet për të siguruar pjesëmarrjen në intervistë formale të prindit apo kujdestarit të personit.	Hapi dokumentohet në B.5		

## HAPAT PËR INTERVISTËN FORMALE TË TË MITURIT

<b>Detyrat/hapat e punonjësit të strukturës vendore antitrafik</b>	<b>Detyrat/hapat e punonjësit të shërbimeve sociale të bashkisë</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/ frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e APAPdhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
Drejtuesi i strukturave vendore për Trafikun e Paligjshëm siguron/cakton ambientin e intervistimit në ambjentet e policisë në përputhje me kushtet e intervistimit.				
Në rast se fëmija është i/e huaj drejtuesi i strukturës vendore për Trafikun e Paligjshëm do të sigurojë praninë e një përkthyesi të licensuar.		Paketa Bazë, Formatit Z.1		
Drejtuesi i strukturave vendore për Trafikun e Paligjshëm liron punonjësin e vet nga detyrat e tjera për të zhvilluar intervistën në orën dhe vendin e caktuar.	Drejtori i shërbimeve sociale të bashkisë liron punonjësin e vet nga detyrat e tjera për të zhvilluar intervistën në orën dhe vendin e caktuar.			
Nëse është vendosur që fëmija të shoqërohet në ambientet e intervistimit nga punonjësi i strukturës vendore për Trafikun të Paligjshëm, ai/ajo		Formulari i Relacionit të identifikimit formal tek AP-ja B 5		

shoqëron fëmijën dhe prindin e kujdestarin si edhe punonjës in e agjencisë që do të marrë pjesë në intervistim formal.				
PMF-ja i shpjegon fëmijës (dhe prindit ose kujdestarit) në një gjuhë të kuptueshme qëllimin e intervistës formale si edhe dallimin midis intervistës formale dhe kallëzimit të veprës penale. Punonjësi/ specialisti i strukturave vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm së bashku me PMF-në zhvillojnë intervistën.		Formulari i Intervistës së fëmijës B.2 Formulari i Relacionit të identifikimit formal tek AP-ja B 5		
Pas mbylljes së intervistës, punonjësi i policisë dhe PMF-ja së bashku me punonjës in e agjencisë që ka shoqëruar fëmijën diskutojnë për statusin e fëmijës në lidhje me trafikimin – nëse është viktimë e trafikimit. Në rast të mosrënies dakord, secili prej tyre njofton gojarisht/me telefon APAP-in, ose në mungesë të tij, D/KAP-in.			APAP-ët komunikojnë së bashku dhe me D/KAP. D/KAP vendos për statusin e personit në lidhje me trafikimin dhe ia komunikon këtë me shkrim sektorit të trafikeve, drejtuesit të sektorit social të bashkisë dhe drejtuesit të agjencisë që ka punonjës në intervistim	
Drejtuesi i strukturës vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm i komunikon vendimin punonjës it të vet/ intervistuesit.	Drejtuesi i sektorit social të bashkisë i komunikon vendimin punonjës it të vet /intervistuesit.			

	PMF thërret anëtarë të GTN-së për takim të menjëhershëm			
Pavarësisht rëniës ose mos rëniës dakord për trafikimin intervistuesit, së bashku me anëtarë të GTN-së të ftuar nga PMF-ja zhvillojnë një takim lidhur me shqyrtimin dhe vendimin në interesit më të lartë të fëmijës duke shqyrtuar sidomos nëse është e sigurt dhe e përshtatshme që fëmija të qëndrojë në ambientin që është aktualisht dhe ndryshimet që duhen bërë për të siguruar këtë.				
Punonjësit e strukturave vendore për Trafikun e Paligjshëm dhe të strukturës sociale të bashkisë/ PMF-ja veprojnë në përputhje me vendimin.				
Shefi i strukturave vendore për Trafikun e Paligjshëm i kërkon AP-së dërgimin e një punonjësi të ndihmës/qendrave rezidenciale nëse është e nevojshme.	PMF njofton masat që duhen marrë dhe kërkon aprovim nga drejtuesi i strukturës sociale të bashkisë <sup>42</sup>			
Pas përfundimit të veprimeve të mësipërme të dy punonjësit hartojnë relacionin për AP dhe ia dërgojnë Sekretariatit të AP-së.		Formulari i Relacionit të identifikimit formal tek AP, B 5		

### HAPAT PËR NTERVISTËN FORMALE TË TË RRITURIT

Detyrat/hapat e punonjësit të strukturës vendore antitrafik	Detyrat/hapat e punonjësit të shërbimeve sociale shtetërore	Dokumentimi nga punonjësit në bazë/ frontline	Detyrat/hapat e APAP dhe afatet	Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë

<sup>42</sup> Bazuar në ligjin nr. 18.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”

				<b>APAP të tjerë dhe afatet</b>
Drejtuesi strukturave vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm siguron/cakton ambientin e intervistimit në ambientet e policisë në përputhje me kushtet e intervistimit.				
Në rast se personi që ka kërkuar intervistë formale është i/e huaj drejtuesi strukturës vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm do të sigurojë praninë e një përkthyesi të licensuar.		Paketa Bazë, Formatit Z.1		
Drejtuesi i strukturave vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm liron punonjësin e vet nga detyrat e tjera për të zhvilluar intervistën në orën dhe vendin e caktuar.	Drejtori i shërbimeve sociale shtetërore liron punonjësin e vet nga detyrat e tjera për të zhvilluar intervistën në orën dhe vendin e caktuar			
Nëse është vendosur që personi të shoqërohet në ambientet e intervistimit nga punonjësi i strukturës vendore për Trafikun e Paligjshëm, ai/ajo shoqëron/sjell atë dhe punonjësin e agjencisë që do të marrë pjesë në vendin e intervistimit formal.		Formulari i Relacionit të identifikimit formal tek AP-ja B 5		

<p>Punonjësi/specialisti i strukturave vendore për Trafikun e Paligjshëm, së bashku me punonjës të shërbimit social shtetëror zhvillojnë intervistën formale. Punonjësi i shërbimit social shtetëror i shpjegon personit në një gjuhë të kuptueshme qëllimin e intervistës formale si edhe dallimin midis intervistës formale dhe kallëzimit të veprës penale.</p>	<p>Formulari i intervistës së të rriturit B.2 Formulari i Relacionit të identifikimit formal tek AP, B 5</p>			
<p>Pas mbylljes së intervistës, punonjësi i policisë dhe ai i shërbimit social së bashku me punonjës të agjencisë që ka shoqëruar personin, diskutojnë për statusin e personit në lidhje me trafikimin/nëse është viktimë e trafikimit. Në rast të mosrënies dakord, secili prej tyre njofton gojarisht/me telefon APAP-in, ose në mungesë të tij, D/KAP-in.</p>				
<p>Pavarësisht rënies ose mosrënies dakord për trafikimin, specialisti i policisë dhe ai i shërbimit social diskutojnë me personin lidhur me asistencën që po merr dhe marrin së bashku një vendim lidhur me ndihmën që do marrë personi dhe akomodimin e tij/saj.</p>				
	<p>Nëse është e nevojshme, punonjësi i shërbimit social i kërkon APAP-it dërgimin e një përfaqësuesi të ndihmës të ndryshëm nga ai ku po ndihmohet personi.</p>	<p>Email/Telefon</p>		
<p>Specialisti i policisë dhe ai i shërbimit social ndihmojnë komunikimin me ofruesin e shërbimit të dërguar nga AP-ja.</p>				

# Planifikim dhe Mbështetje për Riintegrim

*Përkufizimi dhe Përgjegjësitë për mbrojtjen*

“**Planifikim dhe Mbështetje për Rehabilitim dhe Ri/integrim**” është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, në kufijtë dhe brenda territorit të RSH-së, si ata të institucioneve vendore, ashtu edhe ata qendrore dhe përfshin minimalisht: 1. vlerësimin e thelluar të nevojave të personave të trafikuar për ndihmë dhe mbrojtje me pjesëmarrjen e tij/ saj dhe të prindit/ kujdestarit nëse i/e mitur 2. hartimin e planeve të mbështetjes 3. ndihmën direkte për rehabilitimin dhe ri/integrimin/fuqizimin e personit të trafikuar 4. informimin e AP-së për ecurinë e mbështetjes.

**Agjencitë/institucionet përgjegjëse** janë: Organizatat palë në MKR, të gjitha institucionet/organizatat/sectorët të përfshira në identifikimin fillestar.

## STREHIMI I PËRKOHSHËM/QENDRAT E EMERGJENCËS

### HAPAT PËR TË MITURIT

Detyrat/hapat e punonjësit <sup>43</sup>	Dokumentimi nga punonjësit	Detyrat/hapat e Anëtarit të AP-së nga MMSR dhe afatet
Një punonjës social ose psikolog i qendrës bën menjëherë pranimin e të miturit/të miturës.	Deklaratë pranimi	
Një punonjës social ose psikolog i qendrës e njeh menjëherë, të miturin/ën dhe kujdestarin apo prindin, në rast se është me të, me ambientet e qendrës.		
Një mjek i qendrës së emergjencës bën ekzaminimin e fëmijës e në mungesë të tij kërkohet, nëse është e domosdoshme, ndihma e shërbimit shëndetësor të urgjencës.		
Punonjësit e qendrës menjëherë plotësojnë nevojat bazë të të miturit.		

<sup>43</sup> Punonjësi në këtë rast do t'i referohet “Punonjësit të institucionit rezidencial të perkohshëm/ të emergjencës”



Punonjësi i rastit (punonjës social ose psikolog) referon rastin të NJMF pasi plotëson nevojat bazë të të miturit.		
Në rast të largimit të të miturit nga qendra pa leje, punonjësi njofton menjëherë APAP dhe NJMF, si dhe bën kallëzimin në polici.		APAP njofton Sekretariatit e AP
Në rast të kthimit do të kërkohet një vlerësim të situatës social ekonomike njësoj si për kthimin e fëmijës nga jashtë.		
Në rast të kthimit të të miturit në familje/familjen kujdestare punonjësi njofton menjëherë APAP dhe NJMF.		APAP njofton NJMF-në për monitorimin e mëtejshëm të rastit. APAP njofton Sekretariatit e AP

### HAPAT PËR TË RRITURIT

<b>Detyrat/hapat e punonjësit<sup>44</sup></b>	<b>Dokumentimi nga punonjësiti</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit të AP-së nga MMSR dhe afatet</b>
Një punonjës social ose psikolog i qendrës bën menjëherë pranimin e viktimës së mundshme të trafikimit në qendër.	Deklaratë pranimi	
Një punonjës social ose psikolog i qendrës e njeh menjëherë viktimën e mundshme të trafikimit me ambientet e qendrës.		
Një mjek i qendrës së emergjencës bën ekzaminimin e viktimës së mundshme të trafikimit e në mungesë të tij kërkohet, nëse është e domosdoshme, ndihma e shërbimit shëndetësor të urgjencës.		
Punonjësiti e qendrës menjëherë plotësojnë nevojat bazë të viktimës së mundshme të trafikimit.		
Pas plotësimit të nevojave bazë, punonjësi i rastit (punonjës social ose psikolog) harton relacionin për AP ku identifikon edhe nevojën për ndërhyrje të AP-së.	Plotësimi i relacionit të AP	Marrja dhe dërgimi tek Sekretariati i AP i relacionit. APAP kërkon mbledhjen e AP për rastin.
Në rast të largimit të viktimës së mundshme të trafikimit nga qendra pa leje, punonjësi njofton menjëherë APAP.		APAP njofton Sekretariatit e AP
Në rast të referimit të viktimës së mundshme të trafikimit në familje/komunitet punonjësi njofton menjëherë APAP.		APAP njofton DRSHSSH për monitorimin e mëtejshëm të rastit. APAP njofton Sekretariatit e AP

<sup>44</sup> Punonjësi në këtë rast do t'i referohet "Punonjësiti të institucionit rezidencial të perkohshëm/ të emergjencës"

## QENDRAT REZIDENCIALE

### HAPAT PËR TË MITURIT

Detyrat/hapat e punonjësit <sup>45</sup>	Dokumentimi nga punonjësiti	Detyrat/hapat e Anëtarit të AP-së nga MMSR dhe afatet
Një punonjës social ose psikolog i qendrës bën menjëherë pranimin e të miturit/ të miturës.	Deklaratë pranimi	
Një punonjës social ose psikolog i qendrës e njuh menjëherë të miturin/ën dhe kujdestarin apo prindin, në rast se është me të, me ambientet e qendrës.		
Punonjësiti e qendrës menjëherë plotësojnë nevojat bazë të të miturit/miturës.		
Drejtuesi i institucionit rezidencial cakton një punonjës/menaxher të rastit, i cili do të hartojë një plan individual ndihme për rastin në bashkëpunim me ekipin multidisiplinar të institucionit.		
Menaxheri i rastit në një gjuhë të kuptueshme për të miturin i shpjegon atij planin e ndihmës.		
Menaxheri informon prindin/kujdestarin ligjor në rast se ai nuk është i përfshirë për planin e ndihmës, në rast se ai nuk është i dyshuar për trafikimin apo shfrytëzimin e të miturit.		
Pas akomodimit, brenda tre ditëve informohet rasti në lidhje me intervistën formale.		
Menaxheri i rastit njofton APAP për organizimin e intervistës formale.		APAP njofton NJMF dhe punonjësini e policisë antitrafik për kryerjen e intervistës formale
Në rast se i mituri është i huaj, menaxheri i rastit nis menjëherë procedurat për sigurimin e lejes së qëndrimit për të miturin/miturën <sup>46</sup> .	Dokumentimi i lejes së përkohshme “A” ose lejes së qëndrimit “B” nga Autoriteti përgjegjës vendor	APAP informon Sekretariatini e AP-së mbi hapat që janë ndërmarrë lidhur me sigurimin e lejes së qëndrimit

<sup>45</sup> Punonjësi në këtë rast do t’i referohet “Punonjësiti të institucionit rezidencial”

<sup>46</sup> Neni 54 i ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”

	për kufirin dhe migracionin për viktimën/viktimën e mundshme të trafikimit Njofton me e-mail APAP	
Në rast të largimit të të miturit nga qendra pa leje, menaxheri i rastit njofton menjëherë APAP dhe bën kallëzimin në strukturat vendore për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm në DPQ.		APAP njofton Sekretariatën e AP
Në rast të referimit të të miturit në familje/familjen kujdestare, menaxheri i rastit njofton periodikisht NJMF-në për ecurinë dhe informon APAP.	e-mail	APAP njofton NJMF-në për monitorimin e mëtejshëm të rastit. APAP njofton Sekretariatën e AP-së
Menaxheri i rastit bashkëpunon me NJMF dhe PMF verifikon që fëmijës i jepen shërbimet e nevojshme dhe rivlerëson periodikisht dhe sipas nevojës situatën e tij/saj.		

#### HAPAT PËR TË RRRITURIT

<b>Detyrat/hapat e punonjësit<sup>47</sup></b>	<b>Dokumentimi nga punonjësiti</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit të AP-së nga MMSR dhe afatet</b>
Një punonjës social ose psikolog i qendrës bën menjëherë pranimin e viktimës së mundshme të trafikimit në qendër.	Deklaratë pranimi	
Punonjësi social ose psikologu i qendrës, menjëherë e njeh viktimën e mundshme të trafikimit me ambientet e qendrës.		
Drejtuesi i institucionit rezidencial cakton një punonjës/menaxher të rastit, i cili do të hartojë një plan individual ndihme për rastin në bashkëpunim me ekipin multidisiplinar të institucionit.		
Menaxheri i rastit i shpjegon në një gjuhë të kuptueshme planin e ndihmës dhe kërkon bashkëpunimin e tij për zbatimin e tij.	Plani individual i ndihmës	
Menaxheri i rastit, brenda tre ditëve nga akomodimi në institucion, i shpjegon viktimës së mundshme të trafikimit të drejtën për të		

<sup>47</sup> Punonjësi në këtë rast do t'i referohet "Punonjësiti të institucionit rezidencial të perkohshëm/ të emergjencës"

kryer intervistën formale.		
Në rast se viktima e mundshme e trafikimit, është e huaj, menaxheri i rastit nis menjëherë procedurat për sigurimin e lejes së qëndrimit për të <sup>48</sup> .	Dokumentimi i lejes së përkohshme “A” ose lejes së qëndrimit “B” nga Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin për viktimën/viktimën e mundshme të trafikimit  Njofton me e-mail APAP	APAP informon Sekretariatën e AP-së mbi hapat që janë ndërmarrë lidhur me sigurimin e lejes së qëndrimit
Në rast të largimit të viktimës së mundshme të trafikimit nga qendra pa leje, punonjësi njofton menjëherë APAP.		APAP njofton Sekretariatën e AP
Në rast të referimit të viktimës së mundshme të trafikimit në familje/komunitet, punonjësi njofton menjëherë APAP.		APAP njofton DRSHSSH për monitorimin e mëtejshëm të rastit. APAP njofton Sekretariatën e AP

<sup>48</sup> Neni 54 i ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”

**MBROJTJA SOCIALE/SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR RAJONAL/SHËRBIMI SOCIAL I BASHKISË/NJËSIA PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE (NJMF)**

**HAPAT PËR TË MITURIT**

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/ frontline (dhe afatet)</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/ frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor , përfshirë AP-në dhe afatet)</b>
Punonjësi referon menjëherë në një qendër emergjence të miturën/të miturën dhe informon NJMF dhe APAP .		Me marrjen e njoftimit APAP përcjell informacionin tek Sekretariati i AP dhe nëse është e nevojshme kërkon mbledhjen e menjëhershme të AP për menaxhimin e mëtejshëm të rastit	ASHMDF monitoron referimin e rastit dhe plotëson formatin e identifikimit fillestar.  ASHMDF dërgon formatin pranë APAP të MSHMS
Pas marrjes së masave emergjente të mbrojtjes, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës brenda 72 orëve kërkon mbledhjen e GTN dhe përgatit planin individual të mbrojtjes.	Plani individual i mbrojtjes për fëmijën	APAP i MMSR informon Sekretariatit e AP në lidhje me rastin e identifikuar.	ASHMDF njofton APAP nga MMSR në lidhje me hapat e ndërmarrë për rastin.
Menaxheri i rastit i shpjegon në një gjuhë të kuptueshme të miturit/ës dhe prindit/kujdestarit ligjor në rast se ata nuk janë të dyshuar si të përfshirë në trafikim/shfrytëzim, procesin e intervistës formale.		APAP kontakton me APAP-in nga Policia e Shtetit dhe i kërkon koordinimin e kryerjes së intervistës formale.	ASHMDF i kërkon APAP të organizohet kryerja e intervistës formale.
Në rast se i/e mituri/a është i/e huaj NJMF nis menjëherë procedurën e marrjes së lejes së qëndrimit dhe atë të kujdestarisë.			

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/ frontline (dhe afatet)</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/ frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor , përfshirë AP-në dhe afatet)</b>
Në rast se i mituri viktimë e mundshme e trafikimit, është i huaj dhe nuk ka asnjë lloj dokumenti identifikimi, punonjësi i kërkon APAP të negociohet identifikimi dhe pajisja me dokument identifikimi nga përfaqësia diplomatike e vendit të origjinës.		APAP i kërkon Sekretariatit të AP mbledhjen e menjëhershme të AP. Sekretariati kërkon mbledhjen e AP brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit.	

#### HAPAT PËR TË RRITURIT

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/ frontline ( dhe afatet )</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/ frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
Në rast se viktima e mundshme e trafikimit pranon të ndihmohet dhe asistohet në një qendër rezidenciale, atëhere punonjësi e referon rastin menjëherë në qendrën më të afërt.			
Punonjësi, brenda tre ditëve kalendarike njofton APAP në lidhje me hapat e ndërmarrë për rastin.	Njoftimi i AP	APAP informon Sekretariatit e AP.	
Menaxheri i rastit në qendër, brenda 7 ditëve kalendarike, e informon rastin në lidhje me procesin e intervistës formale dhe informon APAP në lidhje me dakordësinë ose jo të kryerjes së intervistës formale.		Në rast se pranohet kryerja e intervistës formale, APAP koordinon kryerjen e saj duke vënë në dijeni edhe Sekretariatit e AP.	

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/ frontline ( dhe afatet )</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/ frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësitor kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
Në rast se viktimat e mundshme të trafikimit është i/e huaj, menaxheri i rastit, brenda tre ditëve kalendrike nis procedurën e aplikimit për leje qëndrimi.			
Në rast se viktimat e mundshme të trafikimit është i huaj, dhe nuk ka asnjë lloj dokumenti identifikimi, punonjësi i kërkon APAP të negociohet pajisja me dokument identifikimi nga përfaqësia diplomatike e vendit të origjinës.		<p>APAP i kërkon Sekretariatit të AP mbledhjen e AP për trajtimin e rastit.</p> <p>APAP mbledh AP brenda 48 orëve nga marrja e njoftimit.</p>	
Në rast se viktimat e mundshme të trafikimit nuk pranon asnjë formë ndihme, punonjësi i kërkon APAP të njoftojë APAP nga policia në lidhje me dyshimet dhe të kërkojë ndjekjen e mëtejshme të rastit.		APAP i MMSR/SHSSH njofton APAP nga Policia e Shtetit dhe Sekretariatit të AP.	

## INSTITUCIONET E KUJDESIT SHËNDETËSOR

**QENDRA SHËNDETËSORE/POLIKLINIKAT/ QENDRAT KOMUNITARE TË SHËNDETIT MENDOR/ SHTËPITË E MBËSHTETURA TË SHËNDETIT MENDOR/ SHËRBIMET SPITALORE NË RRETHE/SPITALET RAJONALE/ SHËRBIMET E SHËNDETIT MENDOR TË SPECIALIZUAR ME SHTRËTËR/DREJTORITE RAJONALE TË SHËNDETËSISË/DREJTORITË E SHËNDETIT PUBLIK**

## HAPAT PËR TË MITURIT

<b>Detyrat/hapat e stafit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor (dhe afatet )</b>	<b>Dokumentimi nga stafi mjekësor</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Dokumentimi nga Anëtari Respektiv i AP-së</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
Në rast se punonjësit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor i kërkojnë ndihmë nga një entitet/strukturë/institucion shtetëror ose joshtetëror për trajtimin mjekësor të një të mituri VMT/VT, ai ofron ndihmën e menjëhershme sipas nevojës.	Njofton me telefon DRSH/DSHP, këta të fundit dhe email APAP.			
Punonjësi i stafit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor orienton përfaqësuesin e institucionit të ndihmës në lidhje me hapat që duhet të ndërmerren më tej në funksion të kujdesit shëndetësor ndaj të miturit.	Dokumentimi mjekësor (rekomandim, recetë mjekësore, etc)			
Punonjësi i stafit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, bazuar në vlerësimin mjekësor paparak të rastit, rekomandon kryerjen e ekzaminimeve mjekësore të specializuara.	Njofton me email DRSH/DSHP, dhe këta të fundit APAP-in në lidhje me rekomandimet e dhëna.	APAP lehtëson kryerjen e ekzaminimeve në klinikat e specialiteteve/qendrat spitalore/qendrat komunitare të shëndetit mendor sipas nevojës.  APAP lehtëson sigurimin e kartës së shëndetit për rastin.	APAP njofton Sekretariatit e AP-së në lidhje me hapat e marrë për ndihmën ndaj rastit.	



## HAPAT PËR TË RRITURIT

<b>Detyrat/hapat e stafit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor (dhe afatet)</b>	<b>Dokumentimi nga stafi mjekësor</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Dokumentimi nga Anëtari Respektiv i AP-së</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë (jashtë përgjegjësit kryesor) , përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
Në rast se, punonjësit të stafit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor i kërkohet ndihmë nga një entitet/strukturë/institucion shtetëror ose joshetëror për trajtimin mjekësor të një VT/VMT, ai ofron ndihmën e menjëhershme sipas nevojës.	Njofton me telefon dhe email DRSH/DSHP, dhe këta të fundit APAP.			
Punonjësi i stafit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor orienton përfaqësuesin e institucionit të ndihmës në lidhje me hapat që duhet të ndërmerren më tej në funksion të kujdesit shëndetësor ndaj rastit.	Dokumentimi mjekësor (rekomandim, recetë mjeksore, etj)			
Punonjësi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor bazuar në vlerësim mjekësor paraprak të rastit, rekomandon kryerjen e ekzaminimeve mjekësore të specializuara.	Njofton me telefon dhe e-mail DRSH/DSHP, këta të fundit APAP-in në lidhje me rekomandimet e dhëna.	APAP lehtëson kryerjen e ekzaminimeve në shërbimet e specializuara të nivelit parësor, sekondar dhe terciar, sipas nevojës APAP lehtëson sigurimin e kartës së shëndetit për rastin sipas legjislacionit në fuqi.	APAP njofton Sekretariatit e AP-së në lidhje me hapat e marrë për ndihmën ndaj rastit.	

## INSTITUCIONET ARSIMORE

### HAPAT PËR TË MITURIT DHE TË RRRITURIT

<b>Detyrat/hapat e punonjësit të arsimit (dhe afatet)</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit e arsimit</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Dokumentimi nga Anëtari Respektiv i AP-së</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë jashtë përgjegjësit kryesor, përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
Punonjësit e arsimit në GTN marrin përsipër detyrimin e ri-regjistrimit të të miturit në institucionet arsimore.				NJMF ose punonjësi e qendrave rezidenciale përgatisin dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin në institucionin arsimor.  Ata shoqërojnë të miturin në institucionin arsimor.
Në rast të referimit nga ana e një entiteti/strukture/ institucioni shtetëror ose joshtetëror të një personi të mitur apo të rritur vmt/vt, punonjësi i arsimit duhet të regjistrojë për vazhdimin e programit mësimor rastin.	Informimi i APAP në lidhje me rastin e referuar	Orientimi i punonjësit të arsimit në lidhje me rastin.  Njoftimi i Sekretariatit të AP.		Sigurimi i dokumenteve të nevojshme për regjistrimin e rastit.

## Planifikim dhe Mbështetje për Kthim Vullnetar të asistuar

“**Planifikim dhe Mbështetje për Kthim Vullnetar të Asistuar**”, është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e personave të trafikuar në kufijtë, brenda dhe jashtë territorit të RSH-së, si ata të institucioneve vendore, ashtu edhe ata qendrore (në veçanti anëtarët e AP-së ) që bën të mundur

kthimin e sigurt, vullnetar dhe të asistuar të një viktimë/viktimë të mundshme trafikimi me shtetësi të huaj në vendin e origjinës. Këto veprime duhet të përfshijnë minimalisht: 1. vlerësimin e situatës së personave në vendin dhe familjen e origjinës para kthimit 2. informimin e personit dhe kujdestarit të tij/saj për vlerësimin 3. marrjen e vendimit të kthimit në interesin më të lartë të fëmijës, personit të trafikuar/tëdyshuar të trafikuar, 4. marrja e masave që kthimi të jetë i asistuar/ i sigurt 5. sigurimin që personat e trafikuar nuk do të ndiqen penalisht në vendin e tyre të kthimit 6. sigurimin e vazhdimësisë së trajtimit të VT/VMT në përputhje me nevojat e tij/ saj 7. parandalimin e riviktimizimit.

**Agjencitë/institucionet përgjegjëse për Fazën IV:** Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Përfaqësitë Diplomatike të RSH-së, Shërbimi Social Shtetëror, ASHMDF, AP/D/KAP, punonjësit e qendrave rezidenciale ku janë strehuar viktimat e mundshme dhe viktimat e trafikimit, punonjësit e Policisë së Kufirit dhe Migracionit.

### *Mjetet dhe kushtet e përdorimit të tyre*

Mjetet e planifikimit dhe mbështetjes për kthim vullnetar të asistuar janë komunikimet, prodhimi dhe shkëmbimi i dokumentacionit në përputhje me parashikimet ligjore

### *Dokumentimi*

Paketa e kthimit vullnetar të asistuar përbëhet nga K.1. kërkesa për vlerësim, K.2. Proces verbal i AP-së lidhur me Kthimin, K.3. Kërkesë për asistimin e kthimit

## HAPAT PËR FËMIJËT

Hapat/nevojat	Përgjegjësi kryesor	Dokumentimi	Afati
Hartimi i kërkesës për gjetjen dhe vlerësimin e familjes dhe riskut në vendin e origjinës.	Punonjësi i rastit i qendrës ku është akomoduar fëmija	Formati K1 Shënimet në database	Sa më shpejt që është e mundur, maksimumi një javë nga mbërritja/ futja e fëmijës në program
Rishikimi dhe dërgimi tek AP-ja i kërkesës.	Drejtuesi i qendrës ku është akomoduar fëmija	Formati K1	Brenda ditës nga përgatitja
Transferimi i kërkesës tek autoritetet e vendit të origjinës që mund të bëjnë vlerësimin.	D/KAP dhe APAP nga MEPJ		
Përcjellja e përgjigjes tek qendra ku është akomoduar	D/KAP dhe APAP nga MEPJ		

fëmija.			
Thirrja e kërkesës për takim për shqyrtimin e interesit më të lartë të fëmijës.	D/KAP	Formati K2 Procesverbali i shqyrtimit të interesit për kthimin	Takimi jo më larg se një javë nga marrja e përgjigjes
Caktimi i detyrave të organizimit të kthimit sipas vendimit.	D/KAP		Në takim
Ndjekja e pajisjes së fëmijës me dokument udhëtimi.	APAP nga Kufiri dhe migracioni		Kërkesa në autoritetet e vendit të origjinës jo më vonë se dy ditë nga caktimi i detyrës
Sigurimi i shoqëruesit të fëmijës.	Qendra ku është akomoduar fëmija		
Sigurimi i fondeve të udhëtimit të fëmijës dhe shoqëruesit.	D/KAP		
Kontrolli mjekësor i fëmijës para udhëtimit.	APAP nga shëndetësia		

#### HAPAT PËR TË RRITURIT

Hapat/nevojat	Pergjegjësi kryesor	Dokumentimi	Afati
Pyetet personi nëse do të zhvillohet një vlerësim para kthimit.	Punonjësi i rastit në qendrën ku është akomoduar personi		
Hartimi i kërkesës për gjetjen dhe vlerësimin e familjes dhe riskut në vendin e origjinës në rast se personi dëshiron.	Punonjësi i rastit në qendrën ku është akomoduar personi	Formati K1 Shënimet në database	Brenda ditës nga shprehja e vullnetit
Rishikimi dhe dërgimi tek AP-ja i kërkesës	Drejtuesi i qendrës ku është akomoduar personi	Formati K1	Brenda ditës nga përgatitja
Transferimi i kërkesës tek autoritetet e vendit të origjinës që mund të bëjnë vlerësimin	D/KAP dhe APAP nga MEPJ		

Përcjellja e përgjigjes tek qendra ku është akomoduar personi.	D/KAP dhe APAP nga MEPJ		
Konsultimi dhe marrja e vendimit të personit.	Punonjësi i rastit dhe drejtuesi i qendrës ku është akomoduar personi		Takimi jo më larg se një javë nga marrja e përgjigjes
Përcjellja e vendimit të personit tek AP-ja.		Kërkesë e personit për asistimin e kthimit K.3	
Thirrja e mbledhjes për kthimin dhe caktimi i detyrave të organizimit të kthimit.	D/KAP		
Ndjekja e pajisjes së personit me dokument udhëtimi.	APAP nga Kufiri dhe migracioni		Kërkesa në autoritetet e vendit të origjinës jo më vonë se dy ditë nga caktimi i detyrës
Sigurimi i fondeve të udhëtimit të personit.	D/KAP		
Kontrolli mjekësor para udhëtimit.	APAP nga shëndetësia		

## PRITJA E PERSONAVE TË TRAFIKUAR ME SHTETËSI SHQIPTARE

“**Pritja e personave të trafikuar me shtetësi shqiptare**”, është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e personave të trafikuar. Këto veprime përfshijnë minimalisht : 1. komunikimet me vendin e destinacionit lidhur me mundësinë e kthimit; 2. vlerësimin e situatës në familjen/ komunitetin e origjinës; 3. përgatitjet paraprake për pritjen; 4. koordinimin e veprimeve për mbrojtje të fazave të tjera/elementëve të tjerë të mbrojtjes.

**Agjencitë / institucionet përgjegjëse**, Agjencitë kryesisht të përfshira në Fazën V janë: Përfaqësitë Diplomatike të RSH-së, Shërbimi Social Shtetëror Qendror dhe Rajonal/Vendor dhe Shërbimet Sociale të Bashkive (SHSB)/punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve (NJMF), punonjësit e Policisë së Kufirit dhe Migracionit dhe AP/D/KAP.

### *Mjetet dhe kushtet e përdorimit të tyre*

Mjetet e pritjes janë komunikimet, prodhimi dhe shkëmbimi i dokumentacionit në përputhje me parashikimet ligjore

### *Dokumentimi*

Paketa e pritjes përbëhet nga: P.1 Njoftimi i AP-së për një person viktimë trafikimi që do të kthehet; P.2 Vlerësimi i situatës; P.3 Proces verbal i AP-së i organizimit të pritjes.

#### **HAPAT PËR PRITJEN (PËR TË MITURIT DHE TË RRITURIT)**

<b>Hapi</b>	<b>Kush i kryen dhe afatet</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Dokumentimi nga Anëtari Respektiv i AP-së/ Sekretariati i AP</b>
Informimi i AP për gjetjen/ndodhjen e personit të trafikuar në vendin e destinacionit/ tranzitit/Dërgimi menjëherë në format elektronik i informacionit tek APAP në MEPJ.	Punonjësi i Përfaqësisë Diplomatike të Republikës së Shqipërisë Afati : Menjëherë	Plotësimi i menjëhershëm i formatit të njoftimit dhe dërgimi tek AP (Sekretariati i AP) në rrugë elektronike.	
Hartimi dhe dërgimi i kërkesës për vlerësimin (socio- ekonomik dhe të sigurisë) tek APAP -ët nga MSHMS.	Sekretariati i AP, Afati: Menjëherë	APAP nga MSHMS/SHSSH kalojnë kërkesën për vlerësim tek Punonjesi Social i Bashkise (NJVRN)/ NJMF Afati : Menjëherë	Ruajtja në dosje elektronike nga Sekretariati i AP e të gjitha komunikimeve në lidhje me rastin.
Vlerësimi.	NJVRN/NJMF NJVRN kryejnë vlerësimin e të rriturve NJMF kryen vlerësimin e të miturve  Afati: brenda 1 jave nga marrja e kërkesës për vlerësim e dërgojnë tek APAP	APAP-ët dërgojnë menjëherë vlerësimin për rastin tek Sekretariati i AP në format elektronik. Afati: Menjëherë	Vlerësimi në AP

Hapi	Kush i kryen dhe afatet	Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet	Dokumentimi nga Anëtari Respektiv i AP-së/ Sekretariati i AP
Vlerësimi dërgohet në vendin e destinacionit/ tranzitit.	APAP i MEPJ Afati: Brenda një jave	D/KAP miraton dhe e dërgon tek APAP i MEPJ përgjigjen për vendin e destinacionit.	Vlerësimi
Priten vendimet dhe arranzhimet e vendit të destinacionit/tranzitit.	PPDRSH komunikon me institucionet partnere në vendin e destinacionit/tranzitit.	APAP i MEPJ njofton Sekretariatit e AP në lidhje me vendimin e autoriteteve homologe të vendit të destinacionit/tranzitit për kthimin vullnetar të asistuar dhe dokumentacionin që mund të kërkohet nga vendi i origjinës (psh autorizimi i prindit/kujdestarit ligjor).	Email
Organizohet pritja.	Sekretariati i AP Afati: Brenda 7 ditëve pune.	Sekretariati i AP komunikon me APAP- ët dhe informon D/KAP.	Email

## Mbështetje e hetimit dhe dënimit të trafikantëve

“Mbështetje e hetimit dhe dënimit të trafikantëve”, është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e personave të trafikuar në kufijtë, brenda dhe jashtë territorit të RSH-së, si ata të institucioneve vendore, ashtu edhe ata qendrore (sidomos anëtarët e AP-së) që bën të mundur grumbullimin dhe analizimin e informacionit për hetimin dhe ndjekjen e trafikantëve. Këto veprime duhet të përfshijnë minimalisht: 1. Informimin e personit dhe kujdestarit të tij/saj për nevojën e ndarjes së informacionit mbi trafikantët e dyshuar; 2. Shoqërimin e personave të trafikuar në identifikim formal; 3. Informimin e AP-së për modus operandi të trafikantëve.

**Agjencitë/institucionet përgjegjëse për Mbështetjen e hetimit dhe dënimit të trafikantëve:** Të gjitha Institucionet e mbrojtjes

## HAPAT: TË MITURIT DHE TË RRRITURIT

<b>Detyrat/hapat e punonjësit në bazë/ frontline (dhe afatet )</b>	<b>Dokumentimi nga punonjësit në bazë/ frontline</b>	<b>Detyrat/hapat e Anëtarit Përkatës të AP-së dhe afatet</b>	<b>Dokumentimi nga Anëtari Respektiv i AP-së</b>	<b>Veprime mbështetëse të aktorëve të tjerë ( jashtë përgjegjësit kryesor), përfshirë APAP të tjerë dhe afatet</b>
Pas çdo interviste të kryer me një rast të dyshuar të trafikuar, punonjësi që kryen intervistën duhet që menjëherë të ndajë informacionin e marrë me APAP (nëse rasti nuk do të pranojë të bashkëpunojë me autoritetet e zbatimit të ligjit).	Formati i intervistës	APAP ndan menjëherë informacionin e marrë me APAP nga Policia e Shtetit (Sektori për Hetimin e Trafikeve të Paligjshme)		APAP nga Policia e Shtetit analizon informacionin dhe sugjeron nëse është e nevojshme nisjen e hetimit proaktiv për rastin.

# Formatet e Dokumentimit

### *Paketa e identifikimit dhe reagimit të menjëhershëm (Formatet Z)*

Format Z.1 DEKLARATË E KONFIDENCIALITETIT/RUAJTJES SË SEKRETIT: Është një format i gatshëm që ka për qëllim të sigurojë që në çdo intervistë me fëmijë apo të rritur ka përkthim të saktë dhe konfidencial.

Format Z.2 VËRTETIM I STATUSIT VIKTIMË E MUNDSHME E TRAFIKIMIT

Format Z.3 DOKUMENTIM I TAKIMIT TË SHQYRTIMIT DHE VENDIMIT NË INTERESIN MË TË LARTË TË FËMIJËS

Format Z.4 DEKLARATË E VENDIMIT TË INFORMUAR PËR NDIHMË



Format Z.5 DEKLARATË E MARRJES NË KUJDES NGA INSTITUCIONI

Format Z.6 DEKLARATË E MARRJES NË KUJDES NGA FAMILJA APO KUJDESTARI

Format Z.7 LEJE E INFORMUAR PËR MBLEDHJE DHE NDARJE INFORMACIONI

Format Z.8 DEKLARATË E VAZHDIMIT TË KUJDESIT DHE PËRGJEGJËSISË

*Paketa e dokumentimit të identifikimit fillestar ( Formatet A)*

Format A.1 KËRKESË ME SHKRIM PËR IDENTIFIKIM NGA POLICIA

Format A .2 INTERVISTA FILLESTARE ME FËMIJËN

Format A.3 DIFERENCIALI I INTERVISTAVE

Format A.4 INTERVISTA FILLESTARE ME TË RRITURIT

Format A.5 NJOFTIM ELEKTRONIK

*Paketa e dokumentimit të identifikimit formal (Formatet B)*

Format B.1 DEKLARATË E VULLNETIT PËR IDENTIFIKIM FORMAL

Format B.2 KËRKESË PËR IDENTIFIKIM FORMAL

Format B.3 FORMAT I INTERVISTËS FORMALE PËR TË MITUR

Format B.4 STRUKTURA E INTERVISTËS FORMALE PËR TË RRITURIT & RELACION PËR INTERVISTËN FORMALE

*Paketa e Kthimit Vullnetar të Asistuar (Formatet K)*

Format K.1 KËRKESË PËR VLERËSIM PARA KTHIMIT

Format K.2 PROCES VERBAL MBLEDHJE E AP-së PËR KTHIMIN VULLNETAR TË ASISTUAR

Format K.3 KËRKESË TEK AP PËR NDIHMË PËR KTHIMIN NË VENDIN E ORIGJINËS

*Paketa E Pritjes (Format P)*

Format P.1 RAPORT PËR VLERËSIMIN E SITUATËS FAMILJARE DHE RREZIKUT PARA KTHIMIT VULLNETAR TË ASISTUAR

**Format Z.1**

**DEKLARATË E KONFIDENCIALITETIT/E RUAJTJES SË SEKRETIT**

**(për t'u plotësuar dhe nënshkruar nga përkthyesit përpara çdo përkthimi të thënieve të viktimave ose personave të dyshuar si viktima apo dokumentave që përmbajnë të dhënat e tyre )**

